



**Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution**

RREGULLORJA

Nr. 02/2016

E PUNËS E INSTITUCIONIT TË AVOKATIT TË POPULLIT

Prishtinë, 2016



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmena • Ombudsperson Institution

Avokati i Popullit,

Në pajtim me nenin 3 dhe nenin 37 të Ligjit Nr. 05/L -019 për Avokatin e Popullit,

Miraton

RREGULLOREN

Nr. 02/2016

E PUNËS PËR INSTITUCIONIN E AVOKATIT TË POPULLIT

KAPITULLI I DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi dhe fushëveprimi

1. Kjo rregullore e punës plotëson dispozitat përkatëse të Ligjit për Avokatin e Popullit, duke:
 - 1.1. Përcaktuar më tej organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Avokatit të Popullit (tani e tutje: IAP) dhe duke definuar rregullat e hollësishme, lidhur me zbatimin e mandatit të IAP-së dhe drejtuesve të saj në procesin e mbrojtjes, mbikëqyrjes dhe promovimit të të drejtave dhe lirive themelore të personave fizikë dhe juridikë nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike, institucioneve dhe personave apo autoriteteve të tjera, të cilat ushtrojnë autorizime publike në Republikën e Kosovës;

- 1.2. Vendosur rregullat e procedurës së brendshme të veprimit, për funksionet institucionale dhe administrative të IAP-së, në procesin e pranimit të ankesave dhe hetimit të tyre, lidhur me shkeljet e pohuara të të drejtave të njeriut, duke përfshirë veprimet apo mosveprimet që paraqesin keqpërdorim të autoritetit;
 - 1.3. Vendosur rregullat e procedurës së brendshme të veprimit për trajtimin e të gjitha rasteve që kanë të bëjnë me diskriminimin, sipas kuptimit të cilësdo nga bazat e përcaktuara në nenin një (1) të Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi dhe të Ligjit për Barazi Gjinore.
 - 1.4. Vendosur rregullat e përgjithshme të procedurës së brendshme të veprimit për Mekanizmin Kombëtar për Parandalimin e torturës dhe trajtimeve e ndëshkimeve të tjera mizore, jonjerëzore dhe poshtëruese;
 - 1.5. Përcaktuar rregullat e shqyrtimit të çështjeve të tjera objekt trajtimi nga ana e IAP-së.
2. Çështjet që lidhen me punën e IAP-së, që nuk janë rregulluar me këtë Rregullore, përcaktohen me ndonjë akt tjetër ose me vendim të Avokatit të Popullit, në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, Ligjin për Avokatin e Popullit dhe ligjet tjera të veçanta.
 3. Këto rregulla nuk shmangin detyrimin për zbatim të dispozitave të ligjit organik të IAP-së, si dhe të ligjeve e akteve të tjera për aq sa ato lidhen me çështjet e trajtuara nga kjo rregullore.

Neni 2

Procedurat e brendshme

1. Procedurat e brendshme përcaktojnë dhe përkufizojnë rregullat e hollësishme të veprimitarisë së IAP-së, të cilat përfshijnë, por nuk kufizohen në:
 - 1.1. Përgjegjësitë, pjesëmarrjen dhe rolin kryesor të IAP-së në procesin e mbrojtjes, mbikëqyrjes dhe promovimit të të drejtave dhe lirive themelore të personave fizikë dhe juridikë, nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike;
 - 1.2. Dispozitat procedurale për paraqitjen, shqyrtimin dhe hetimin e ankesave, kërkesave dhe njoftimeve në IAP, lidhur me shkeljet e pohuara të të drejtave të njeriut, duke përfshirë veprimet apo mosveprimet që paraqesin keqpërdorim të autoritetit; trajtimin e të gjitha rasteve që kanë të bëjnë me diskriminimin dhe barazinë gjinore, të drejtat e fëmijëve, parandalimin e torturës dhe trajtimeve e ndëshkimeve të tjera mizore, jonjerëzore dhe poshtëruese, si dhe çështjeve të tjera të parashikuara me ligjin në fuqi;
 - 1.3. Promovimin e mbrojtjes ligjore të të drejtave dhe lirive themelore të personave fizikë dhe juridikë dhe qeverisjen e zellshme;

- 1.4. Procesin e propozimit, hartimit dhe aprovimit të politikave në çështjet që kanë të bëjnë me administrimin e IAP-së, përfshirë, por jo të kufizuara në: organizimin e brendshëm dhe funksionimin, buxhetin, personelin, statusin dhe çështjet kontraktuese të stafit, kushtet e punësimit, pushimet dhe orarin e punës, kompensimin dhe Kodin e etikës, miratimin e programeve, planeve dhe raporteve të punës, si dhe çështjeve të tjera që ndërlidhen me administrimin e IAP-së;
 - 1.5. Nxjerrjen e akteve nënligjore të IAP-së për ruajtjen dhe realizimin e pavarësisë funksionale, organizative, administrative e financiare; si dhe rregullimin e proceseve të punës dhe vendosjen e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe të kulturës organizative të orientuar në performansë, forcimin e strukturës administrative dhe ngritjen e kapaciteteve për arritje të objektivave dhe përmbushjen e misionit të IAP-së.
2. Në rast të mungesës së dispozitave procedurale, IAP mund të zbatohet në mënyrë të arsyeshme dhe analoge dispozitat përkatëse të ligjeve të tjera procedurale, duke marrë parasysh natyrën e çështjes, si dhe specifikat e procedurës para IAP-së në trajtimin e ankesave, lidhur me shkeljet e pohuara të të drejtave të njeriut, duke përfshirë veprimet apo mosveprimet që paraqesin keqpërdorim të autoritetit.

Neni 3

Parimet e veprimitarisë dhe të funksionimit të brendshëm

1. IAP përmbush detyrat e tij në mbrojtje, mbikëqyrje dhe promovim të të drejtave dhe lirive të njeriut, të parashikuara me Kushtetutë, aktet ndërkombëtare të përfshira në Kushtetutën e Kosovës dhe legjislacionin e Kosovës, në mënyrë efektive dhe ushtron aktivitetin e tij institucional dhe administrativ në mënyrë transparente dhe të përgjegjshme, me mbarëvajtje efektive dhe ekonomike, dhe në respektim të plotë të parimit të ligjshmërisë, paanësisë, pavarësisë, epërsisë së të drejtave të njeriut, konfidencialitetit dhe profesionalizmit.
2. Dispozitat në vijim mbështeten në parimet e përgjithshme të trajtimit të barabartë të punonjësve, në parimin e profesionalizmit, të pavarësisë dhe integritetit, të paanësisë, të transparencës, të shërbimit ndaj publikut, të vazhdimësisë së karrierës, të përgjegjësisë dhe korrektësisë në zbatimin e legjislacionit në fuqi dhe kodit të etikës.

Neni 4

Interpretimi i Rregullores

1. Avokati i Popullit i interpreton dispozitat e kësaj rregulloreje, jep udhëzime dhe kujdeset për zbatimin e duhur të tyre.

2. Të gjitha termet në tekst janë të përdorura në gjininë mashkullore gramatikore, por që nënkuptojnë edhe gjininë femërore dhe zbatohen në mënyrë të barabartë.

KAPITULLI II

THEMELIMI, EMBLEMA, VULA DHE GJUHA

Neni 5

Themelimi dhe përfaqësimi

1. IAP është institucion i pavarur kushtetues i themeluar në bazë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe Ligjit Nr. 05/L -019 për Avokatin e Popullit.
2. Selia e IAP-së është në Prishtinë, ndërsa ka zyre të hapura edhe në qytetet e tjera të Kosovës.
3. Avokati i Popullit përfaqëson IAP-në në të gjitha fushat e veprimtarisë të përcaktuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, Ligjin për Avokatin e Popullit, Ligjin për mbrojtje nga diskriminimi, Ligjin për barazinë gjinore, ligjet e tjera të veçanta, si dhe instrumentet ndërkombëtare të përfshira në Kushtetutën e Kosovës, si dhe këtë rregullore pune.

Neni 6

Emblema

1. IAP ka emblemën e tij, e cila me figurën qendrore në të e përfaqëson vetë Avokatin e Popullit duke e mbajtur diellin apo një dritë sipër kokës së tij si simbol i ndriçimit të mendjes, paqes, prosperitetit dhe pajtimit, për të cilat institucioni angazhohet dhe të cilat ia sjell Kosovës.
2. Në letërkëmbim emblema e IAP-së përdoret e kombinuar me stemën e Republikës së Kosovës, e cila vendoset në anën e majtë të epërme të shkresës.

Neni 7

Vula

1. IAP ka vulën e vet, e cila përmban stemën e Republikës së Kosovës të rrethuar me mbishkrimin “Republika e Kosovës - Institucioni i Avokatit të Popullit - Prishtinë”, në shqip dhe serbisht

Neni 8

Gjuha

Gjuhë e punës së Institucionit të Avokatit të Popullit janë gjuhët zyrtare të parapara me Kushtetutë dhe ligj.

KAPITULLI III

MISIONI, MANDATI, PËRBËRJA DHE ORGANIZIMI

Neni 9

Misioni

Misioni i IAP-së, si mekanizëm ligjor, është mbrojtja, mbikëqyrja dhe promovimi i të drejtave dhe lirive themelore të personave fizikë dhe juridikë nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike, institucioneve dhe personave apo autoriteteve të tjera, të cilat ushtrojnë autorizime publike në Republikën e Kosovës nëpërmjet: pranimit dhe hetimit të ankesave për shkeljet e pohuara të të drejtave të njeriut nga autoritetet publike në Kosovë, parandalimi i torturës dhe trajtimeve e ndëshkimeve të tjera mizore, jonjerëzore dhe poshtëruese, mbrojtja nga diskriminimi dhe barazia gjinore, për t'i kontribuar qeverisjes së mirë, transparencës dhe llogaridhënies së administratës publike para qytetarëve të Kosovës dhe forcimit të sundimit të ligjit në epiqendër të së cilit qëndrojnë mbrojtja dhe respektimi i të drejtave të njeriut në Kosovë.

Neni 10

Organizimi i punës së IAP-së

1. IAP gëzon pavarësi funksionale, organizative, administrative e financiare për realizimin e kompetencave, përgjegjësi dhe detyrave të përcaktuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, Ligjin për Avokatin e Popullit, Ligjin për mbrojtje nga diskriminimi, Ligjin për barazinë gjinore, ligjet e tjera të veçanta, si dhe mekanizmat e standardeve ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, veçanërisht në Parimet e Parisit dhe Udhëzuesin për institucionet e Avokatit të Popullit.
2. IAP përcakton organizimin e vet të brendshëm të punës, strukturën organizative, proceset e vendimmarrjes dhe çështje të tjera organizative në pajtim me Ligjin për Avokatin e Popullit, këtë rregullore të punës, rregulloren për strukturën organizative dhe aktet e tjera nënligjore.

Neni 11

Fushat e përgjegjesisë dhe përcaktimi i strukturës organizative

1. Kompetencat dhe përgjegjësit kushtetuese dhe ligjore të IAP-së, në varësi të natyrës dhe çështjeve të ngjashme, ndahen dhe përmbledhen në gjashtë (6) fusha të veçanta (tani e tutje sektorë), në kuadër të së cilave veprojnë njësit e veçanta organizative me përgjegjësi dhe detyra të caktuara:
 - 1.1. Sektori për Mbrojtjen dhe Mbikëqyrjen e të Drejtave të Njeriut
 - 1.1.1. Departamenti për Pranim dhe Administrim të Ankesave
 - 1.1.2. Departamenti i Hetimit të Ankesave
 - 1.2. Sektori për Mbrojtjen nga Diskriminimi
 - 1.2.1. Departamenti për Mbrojtje nga Diskriminimi
 - 1.2.2. Departamenti për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve
 - 1.3. Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës
 - 1.3.1. Departamenti për Parandalimin e Torturës
 - 1.4. Sektori i Hulumtimit dhe Shërbimit Juridik
 - 1.4.1. Departamenti i Çështjeve Juridike
 - 1.5. Sektori për Raportimin dhe Promovimin e të Drejtave të Njeriut
 - 1.5.1. Departamenti për Bashkëpunim, Raportim dhe Promovim të të Drejtave të Njeriut
 - 1.6. Sektori i Shërbimeve të Përgjithshme
 - 1.6.1. Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm
 - 1.6.2. Departamenti i Administratës
2. Bazuar në nenin 37 të Ligjit Nr. 05/L -019 për Avokatin e Popullit, përcaktimi i strukturës organizative të IAP-së dhe sistematizimi i vendeve të punës, përfshirë krijimin e njësive organizative të nevojshme, emërtesat, funksionet dhe përgjegjësit e tyre; nivelet e drejtuesve të njësive organizative si dhe përshkrimet e detyrave të punës të stafit të IAP-së, përcaktohen në mënyrë të veçantë me Rregulloren për strukturën organizative dhe sistematizimin e vendeve të punës në IAP.

Neni 12

Kompetencat dhe përgjegjësitë e IAP-së

1. IAP është institucion i pavarur kushtetues për mbrojtjen, mbikëqyrjen dhe promovimin e të drejtave dhe lirive të njeriut, i krijuar në bazë të Kushtetutës dhe Ligjit për Avokatin e Popullit.

2. Kompetencat, përgjegjësitë, dhe rregullat themelore normative të cilat përfshijnë funksionin e IAP-së në fushën e mbrojtjes, mbikëqyrjes dhe promovimit të të drejtave dhe lirive të njeriut, janë të përcaktuara me nenet 132, 133, 134 dhe 135 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës; Ligjin Nr. 05/L -019 për Avokatin e Popullit, Ligjin Nr. 05/L -021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Ligjin Nr. 05/L -020 për Barazinë Gjinore, si dhe me ligjet e tjera të veçanta dhe nga kjo rregullore.
3. IAP është themeluar si mekanizëm i veçantë ligjor për të implementuar legjislacionin në fuqi në kuadër të fushës së mbrojtjes, mbikëqyrjes dhe promovimit të të drejtave dhe lirive të njeriut, me kompetenca dhe përgjegjësi të veçanta për pranimin, shqyrtimin dhe hetimin e ankesave, kërkesave dhe njoftimeve në IAP; trajtimin e të gjitha rasteve që kanë të bëjnë me diskriminimin, barazinë gjinore dhe të drejtat e fëmijëve; parandalimin e torturës dhe trajtimeve e ndëshkimeve të tjera mizore, jonjerëzore dhe poshtëruese; si dhe promovimin e mbrojtjes ligjore të të drejtave dhe lirive themelore të personave fizikë dhe juridikë.

Neni 13

Përbërja e IAP-së

1. Në përputhje me nenin 5 të Ligjit, Nr. 05/L -019 për Avokatin e Popullit, Institucioni i Avokatit të Popullit, përbëhet nga:
 - 1.1. Avokati i Popullit;
 - 1.2. Pesë (5) zëvendës të Avokatit të Popullit dhe
 - 1.3. Personeli i Institucionit të Avokatit të Popullit.

Neni 14

Procedura e zgjedhjes dhe përfundimit të mandatit të Avokatit të Popullit dhe zëvendësve të tij

Propozimi, kushtet dhe procedura e zgjedhjes, si dhe shkarkimi dhe përfundimi i mandatit të Avokatit të Popullit dhe zëvendësve të tij, janë të përcaktuara me nenin 134 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe me nenet 8 deri në 14 të Ligjit për Avokatin e Popullit.

Neni 15

Funksionet e Avokatit të Popullit

1. Përveç kompetencave, përgjegjësiave dhe funksioneve të përcaktuara me Kushtetutën e Kosovës, Ligjin për Avokatin e Popullit, Ligjin për mbrojtjen nga diskriminimi, Ligjin për Barazi Gjinore dhe ligjet e veçanta, si dhe me këtë rregullore, Avokati i Popullit:

- 1.1. Drejton IAP-në dhe miraton politikat e veprimit, strategjitë dhe programet e zhvillimit dhe bën mbikëqyrjen e ekzekutimit dhe respektimit të kornizës ligjore dhe rregulloreve tëpunës në kuadër të fushës së përgjegjësisë dhe mandatit të IAP-së.
- 1.2. Siguron që IAP të formulojë dhe vendos qartë prioritetet për ndarjen e mjeteve financiare që i vihen në dispozicion nga buxheti i Republikës së Kosovës apo donacionet e jashtme.
- 1.3. Siguron ndarjen më të përshtatshme, transparente dhe të përgjegjshme të fondeve që IAP i merr nga buxheti dhe donatorët e jashtëm.
- 1.4. Kujdeset për zhvillimin dhe mbajtjen e sistemeve, procedurave dhe proceseve adekuate për të ndihmuar funksionimin e IAP-së.
- 1.5. Aprovon politika të qarta të ngritjes së kapaciteteve dhe aftësisë të stafit në fushat e përgjegjësisë të IAP-së.
- 1.6. Merr masa dhe mbikëqyrë administrimin e IAP-së, për të siguruar funksionimin e vazhdueshëm të tij.
- 1.7. Kryeson të gjitha takimet e Kolegjiumit të IAP-së.
- 1.8. Informon zëvendësit e Avokatit të Popullit për të gjitha çështjet në zhvillim e sipër dhe ato të ardhshme, proceset dhe veprimet që kanë të bëjnë me IAP-në.
- 1.9. Përfaqëson IAP-në para institucioneve vendore e ndërkombëtare.
- 1.10. Përcakton se cili zëvendës i Avokatit të Popullit apo anëtar përfaqëson IAP-në, në rastet kur IAP-së i dërgohen ftesa.
2. Deleton detyra dhe përgjegjësi të caktuara zëvendësve të Avokatit të Popullit ose anëtarëve të tjerë të IAP-së, në përputhje me vlerësimet, rrethanat dhe nevojat e paraqitura.
3. Për punën e IAP-së i përgjigjet Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Neni 16

Përgjegjësitë administrative

1. Me propozimin e zëvendësve të Avokatit të Popullit, të Sekretarit të Përgjithshëm dhe të Kabinetit të tij, konsultimeve të zhvilluara dhe vlerësimeve paraprake, Avokati i Popullit, vendos për çështjet që kanë të bëjnë me aprovimin e politikave të administrimit të përgjithshëm të IAP-së, të cilat përfshijnë, por nuk kufizohen në:
 - 1.1. Miratimin e prioriteteve dhe sigurimin e ndarjes më të përshtatshme, transparente dhe të përgjegjshme të burimeve që i vihen në dispozicion IAP-së nga buxheti apo donatorët.
 - 1.2. Vendosjen për propozimin përfundimtar të buxhetit të IAP-së dhe përcjelljen e tij Kuvendit të Kosovës, për procedurë të mëtejshme të aprovimit.

- 1.3. Aprovimin e sistemeve, procedurave dhe proceseve adekuate në përkrahje të funksionimit dhe funksionalitetit të IAP-së.
- 1.4. Përcaktimin e politikave për ngritje të kapaciteteve dhe miratimin e programit të aftësisë për personelin e IAP-së në fushat përkatëse të përgjegjësisë.
- 1.5. Miratimin e një sistemi informues për menaxhimin e të dhënave, në mënyrë që të gjitha vendimet, politikat dhe proceset e veprimit të mbështeten në një bazë të të dhënave të sakta, të plota dhe të përditësuara.
- 1.6. Përcaktimin e kushteve të punësimit, orarin e punës, kompensimin dhe kodin e etikës, për nëpunësit civil të IAP-së.
- 1.7. Angazhimin e ekspertëve për konsultime dhe ekspertiza profesionale mbi bazën e kontratave për shërbime të veçanta.
- 1.8. Organizimin e brendshëm dhe funksionimin e IAP-së.
- 1.9. Shqyrtimin dhe miratimin e Programit dhe Planin njëvjeçar të punës së tij.
- 1.10. Shqyrtimin dhe miratimin e Raportit njëvjeçar të punës.
- 1.11. Zhvillimin e takimeve për çështje administrative, në intervale kohore të cilat nuk tejkalojnë tre muaj, me përjashtim të rasteve kur me kërkesën e arsyetuar të zëvendësve të Avokatit të Popullit apo Sekretarit të Përgjithshëm, takimet mund të caktohen edhe para afatit prej tre muajsh.

Neni 17

Detyrat e zëvendësit kryesor të Avokatit të Popullit

1. Në përputhje me nenin 14, paragrafin 2 të Ligjit për Avokatin e Popullit, zëvendësi kryesor i Avokatit të Popullit, zëvendëson Avokatin e Popullit në rast mungese, vdekje, paaftësie të përhershme ose të përkohshme, dorëheqjes ose shkarkimit.
2. Merr pjesë në aktivitetet dhe realizimin e të gjitha funksioneve të IAP-së të parashikuara me kuadrin ligjor dhe aktet nënligjore të IAP-së.
3. Angazhohet edhe në çështje dhe aspekte të tjera pune në përputhje me Rregulloren e punës dhe procedurat përkatëse në zbatim të Programit të zhvillimit të IAP-së dhe Planit të Punës.

Neni 18

Përgjegjësitë e zëvendësve të Avokatit të Popullit

1. Zëvendësit e Avokatit të Popullit ushtrojnë me ndërgjegje, dinjitet dhe në mënyrë të paanshme funksionin e tyre në IAP dhe angazhohen në mbrojtjen, mbikëqyrjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut në pajtim me dispozitat ligjore, standardet

ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, Rregulloren e punës dhe aktet e tjera nënligjore të IAP-së.

2. Secili zëvendës i Avokatit të Popullit, sipas ndarjes që bën Avokati i Popullit, është përgjegjës për njëren prej fushave të ndara të përgjegjësive (sektorëve) të IAP-së dhe ka për detyrë të marrë pjesë në punët dhe procesin e vendimmarrjes së IAP-së, si dhe të kryejë punët e tjera, të përcaktuara me ligj, standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe me këtë rregullore pune, siç janë:
 - 2.1. Drejtimi i njërit nga sektorët, sipas ndarjes që bën Avokati i Popullit me vendim të veçantë, duke siguruar mbarëvajtjen e përgjithshme të punëve në përmbushje të funksioneve dhe përgjegjësive të përcaktuara brenda fushëveprimit të Sektorit.
 - 2.2. Pjesëmarrja në takimet e Kolegjiumit të IAP-së, duke kontribuar në trajtimin me kompetencë të çështjeve të propozuara për diskutim dhe vendosje, si dhe përfshirja në zgjidhjen e rasteve më të ndërlikuara nga fushë veprimi i Sektorit.
 - 2.3. Koordinimi i aktiviteteve dhe bashkërendimi i veprimeve me drejtorët e departamenteve dhe/apo udhëheqësit e zyrave, që veprojnë përbrenda sektorëve që drejtojnë, për të përmbushur përgjegjësitë dhe kryer detyrat nga fushë veprimi i Sektorit.
 - 2.4. Pjesëmarrja në ekzaminimet paraprake të kërkesave dhe të ankesave, si dhe në finalizimin e draft vendimeve, lidhur me refuzimin apo pranueshmërinë e kërkesave dhe /apo ankesave të parashtruara IAP-së.
 - 2.5. Asistimi në përpilimin dhe përmbledhjen e raporteve specifike për gjendjen e drejtave të njeriut dhe dhënien e rekomandimeve për masat shtesë në mbrojtjen, mbikëqyrjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut.
 - 2.6. Pjesëmarrja dhe dhënia e kontributit në çështjet e ndërtimit të politikave të administrimit të IAP-së, në propozimin dhe përgatitjen e politikave të veprimit, programeve dhe strategjisë së zhvillimit në fushën e të drejtave të njeriut, në inicimin dhe propozimin e ndërmarrjes së masave, veprimeve dhe aktiviteteve për adresimin dhe zbatimin e mandatit të IAP-së.
 - 2.7. Pjesëmarrja në hartimin e raporteve vjetore dhe të posaçme të IAP-së, si dhe angazhimi dhe përfshirja edhe në punë të tjera, si dhe në zgjidhjen e çështjeve, sipas udhëzimeve dhe porosive të Avokatit të Popullit.
 - 2.8. Përfaqësimi i IAP-së në aktivitete të ndryshme nga fushë veprimi i sektorit që mbulojnë.
 - 2.9. Angazhimi në çështje dhe aspekte të tjera pune në përputhje me këtë Rregullore të punës dhe procedurat përkatëse në zbatim të Programit të zhvillimit të IAP-së.

Neni 19

Shërbimi Profesional dhe Administrativ

1. Përveç funksioneve dhe përgjegjësi të caktuara nga Ligji për Avokatin e Popullit, Ligji për Mbrojtje nga Diskriminimi, Ligji për Barazi Gjinore, ligjet e tjera në fuqi dhe standardet ndërkombëtare, Shërbimi profesional dhe administrativ i IAP-së ka përgjegjësinë e përgjithshme për sigurimin dhe ofrimin e shërbimeve profesionale, administrative, teknike dhe shërbimeve të tjera mbështetëse për IAP-në.
2. Përshkrimi i plotë i mandatit, funksioneve dhe struktura organizative e Shërbimit profesional dhe administrativ përcaktohet me Rregulloren e posaçme për strukturën organizative dhe sistematizimin e vendeve të punës në IAP.

Neni 20

Personeli i Shërbimit Profesional dhe Administrativ

1. Në përputhje me nenin 32 të Ligjit për Avokatin e Popullit, personeli i Institucionit të Avokatit të Popullit zgjidhet në mesin e qytetarëve të Republikës së Kosovës, në një proces të hapur dhe transparent, bazuar në kriteret profesionale, aftësi dhe meritë, përmes konkursit të drejtë, në pajtim me aktet nënligjore të IAP-së dhe legjislacionin për shërbimin civil, për aq sa nuk cenohet pavarësia kushtetuese e IAP-së, si dhe për aq sa ato gjejnë zbatim në rastet konkrete.
2. Në kuptim të nenit 32, paragrafi 2, të Ligjit për Avokatin e Popullit, ndaj statusit të personelit të Shërbimit Profesional dhe Administrativ, do të zbatohen dispozitat e Ligjit për Shërbimin Civil, deri në atë masë sa të mos kenë ndikim dhe të cenojnë pavarësinë e IAP-së, të garantuar me nenin 132, paragrafi 2 dhe nenin 133, paragrafi 1, të Kushtetutës dhe me nenin 3 të Ligjit për Avokatin e Popullit.
3. Bazuar në nenin 132, paragrafi 2 dhe neni 133, paragrafi 1, të Kushtetutës, në nenin 3 të Ligjit për Avokatin e Popullit, në standardet dhe parimet e shërbimit civil, në respektim të plotë të pavarësisë së IAP-së dhe në zbatim të nenit 32, paragrafi 2, të Ligjit për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit miraton politikat e personelit dhe procedurat, duke përfshi: planifikimin, kushtet e punësimit dhe rekrutimin e personelit, orarin e punës dhe pushimet, shtesat dhe kompensimet, procedurën për disiplinim dhe të ankesave të të punësuarve, ngritjen e kapaciteteve dhe trajnimet, vlerësimin e performansës si dhe çfarëdo politike apo procedurë tjetër të cilat Avokati i Popullit i sheh si të këshillueshme dhe të domosdoshme për menaxhimin e pavarur të resurseve njerëzore.
4. Klasifikimet, avancimet dhe gradimet e personelit bëhen në përputhje me aktet nënligjore përkatëse të IAP-së dhe me kriteret dhe kushtet e përcaktuara në legjislacionin për shërbimin civil, për aq sa nuk cenohet pavarësia kushtetuese e IAP-së dhe për aq sa ato gjejnë zbatim në rastet konkrete.
5. Shërbimi Profesional dhe Administrativ do të ketë personel të nevojshëm për t'i mundësuar atij përmbushjen e funksioneve në mënyrë efektive dhe efikase, brenda resurseve buxhetore të ndara IAP-së.

6. Pagat, shtesat dhe kompensimet e personelit të shërbimit profesional dhe administrativ sigurohen nga linja buxhetore e IAP-së, në përputhje me kornizën ligjore.

Neni 21

Sekretari i Përgjithshëm

1. Sekretari i Përgjithshëm drejton dhe është përgjegjës për administrimin e përgjithshëm dhe menaxhimin e Shërbimit Administrativ, për të siguruar se funksionet e caktuara të IAP-së përmbushen në mënyrë efektive dhe efikase;
2. Përgjegjësitë konkrete dhe detyrat e punës së Sekretarit të Përgjithshëm përcaktohen me Rregulloren për organizimin e brendshëm, funksionet dhe sistematizimin e vendeve të punës në IAP.
3. Avokati i Popullit emëron Sekretarin e Përgjithshëm, duke u bazuar në një proces transparent, të hapur dhe konkurrues të përzgjedhjes.
4. Sekretari i Përgjithshëm duhet të ketë, së paku, kualifikimet minimale të përcaktuara më poshtë:
 - 4.1. përgatitje superiore shkollore në fushën e të drejtave të njeriut, administratës publike, drejtësisë, ekonomisë dhe/apo të lëmi të ngjashme.
 - 4.2. së paku tetë (8) vite përvojë pune profesionale, duke përfshirë së paku 5 vite në vende udhëheqëse dhe
 - 4.3. të jetë person me integritet të lartë personal dhe moral.
5. Konkursi për postin e Sekretarit të Përgjithshëm, shpallet së paku në dy gazeta të cilat shpërndahen gjerësisht në Kosovë.
6. Aplikacionet për postin e Sekretarit të Përgjithshëm shqyrtohen nga paneli përzgjedhës i emëruar nga Avokati i Popullit, i përbërë nga së paku prej 3 (tre) anëtarëve, 2 (dy) prej të cilëve janë zëvendës të Avokatit të Popullit, ndërsa anëtari i tretë caktohet nga sektori i shoqërisë civile për të drejtat e njeriut.
7. Komisioni për përzgjedhje i paraqet për vendim Avokatit të Popullit listën prej 2 (dy) kandidatëve të cilët përmbushin kërkesat e përcaktuara në paragrafin 3 të këtij neni.
8. Sekretari i Përgjithshëm suspendohet përkohësisht apo shkarkohet me vendimin e Avokatit të Popullit, për mosplotësimin e detyrave, për shkelje të rëndë të ligjit dhe të kësaj rregulloreje, në pajtim me kuadrin ligjor dhe aktet nënligjore përkatëse të IAP-së.
9. Në përputhje me kërkesat e parashikuara në kuadrin normativ si dhe me urdhrat apo detyrat e marra nga Avokati i Popullit, Sekretari i Përgjithshëm merr masa për shfrytëzimin e frytshëm të burimeve njerëzore, të mjeteve financiare e burimeve materiale të IAP-së.
10. Përgjegjësia e Sekretarit të Përgjithshëm nuk shmang përgjegjësinë e çdo strukture organizative të IAP-së apo të çdo nëpunësi, por konsiston në detyrimin e tij për të

mbikëqyrur kryerjen e detyrave prej tyre dhe kur vëren parregullsi e të meta, të urdhërojë marrjen e masave të nevojshme për funksionimin e administratës.

11. Sekretari i Përgjithshëm ka për detyrë përmirësimin e standardeve në të gjitha shërbimet e ofruara nga IAP, duke siguruar e plotësuar kushtet e nevojshme të punës për çdo departament, divizion, zyrë, njësi apo punonjës i saj që të kryejë detyrat në përputhje me ligjet dhe me Rregulloren e punës dhe aktet nënligjore të IAP-së.
12. Në mungesë të Sekretarit të Përgjithshëm apo kurdoherë që Sekretari i Përgjithshëm nuk është në gjendje të ushtrojë funksionet e tij, Avokati i Popullit cakton njërin nga drejtorët e departamenteve ushtrues detyrë të Sekretarit të Përgjithshëm.
13. Sekretari i Përgjithshëm për punën e tij i përgjigjet Avokatit të Popullit.
14. Mandati i Sekretarit të Përgjithshëm është 4 (katër) vjet, me mundësi riemërimi.
15. Vlerësimi i performansës bëhet nga ana e Avokatit të Popullit në fund të çdo viti në bazë të planit vjetor që paraqet Sekretari i Përgjithshëm.

Neni 22

Ekspertët dhe konsulentët e jashtëm

1. Në përputhje me nenin 33 të Ligjit për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit mund të angazhojë këshilltar dhe ekspertë të jashtëm për t'i shërbyer për një periudhë të caktuar.
2. Po ashtu, Sekretari i Përgjithshëm, me miratimin paraprak të Avokatit të Popullit, mund të kontraktojnë ekspertë dhe profesionistë nga jashtë për të ushtruar shërbime dhe ofruar asistencë teknike të caktuar, sipas nevojës së paraqitur dhe në përputhje me rregullat dhe procedurat e përcaktuara.
3. Kohëzgjatja e angazhimit të ekspertëve dhe konsulentëve të jashtëm, përgjegjësitë, detyrat dhe të drejtat që u përkasin, si dhe mënyra e pagesës, përcaktohen me marrëveshje për kryerje shërbimesh.

Neni 23

Buxheti dhe financat

1. IAP financohet nga buxheti i Republikës së Kosovës dhe nga donacione të jashtme, në përputhje me rregullat dhe procedurat ligjore.
2. Njësia përkatëse e Shërbimi Administrativ përgatit propozimin për buxhetin dhe i paraqet atë Avokatit të Popullit për shqyrtim.
3. Propozim buxheti vjetor i IAP-së, nuk mund të jetë më i vogël se buxheti i miratuar për vitin e mëparshëm dhe ia dërgon propozimin e tillë Kuvendin të Kosovës.

4. Propozimi përfundimtar i buxhetit nënshkruhet nga Avokatit të Popullit dhe dorëzohet nga Sekretari i Përgjithshëm në procedurë të mëtejshme të aprovimit në Kuvendin e Republikës së Kosovës.
5. Buxheti i propozuar nga IAP përfshihet në tërësi në propozimin e buxhetit të Republikës së Kosovës që i paraqitet Kuvendit të Republikës së Kosovës për aprovim, dhe mund të shkurtohet vetëm me miratimin e Avokatit të Popullit.
6. Në rast të shtimit të obligimeve dhe kompetencave të Institucionit të Avokatit të Popullit, kjo përcillet edhe me burime shtesë përkatëse dhe adekuate financiare dhe njerëzore, të cilat duhet të sigurohen me rastin e propozimit të buxhetit dhe/apo rishikimit të tij.
7. IAP menaxhon në mënyrë të pavarur buxhetin e tij dhe i nënshtrohet auditimit të brendshëm dhe të jashtëm.
8. IAP ka kodin buxhetor të pavarur.

Neni 24

Pranimi i donacioneve

1. Institucioni i Avokatit të Popullit mund të pranojë donacione shtesë financiare dhe materiale nga donatorët vendorë dhe ndërkombëtarë, të cilat nuk ndikojnë në pavarësinë funksionale dhe financiare të Institucionit të Avokatit të Popullit dhe nuk janë në kundërshtim me ligjin.
2. Me pranimin e donacionit prej donatoreve njoftohet edhe Kuvendi i Republikës së Kosovës.
3. Pranimi i donacionit nuk mund të ndikojë në të drejtat e IAP-së prej buxhetit të Republikës së Kosovës.
4. Regjistrimi dhe administrimi i donacioneve bëhet në përputhje me kriteret dhe procedurën ligjore.

Neni 25

Pagat

1. Në përputhje me nenin 34 të Ligjit për Avokatin e Popullit, pagat në Institucionin e Avokatit të Popullit rregullohen sipas ligjit përkatës për pagat nga buxheti i Republikës së Kosovës.
2. Deri në aprovimin e Ligjit për Pagat nga Buxheti i Republikës së Kosovës, paga, shtesat dhe kompensimet për Avokatin e Popullit dhe për zëvendësit e Avokatit të Popullit, përcaktohen me vendim të posaçëm të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

3. Paga, shtesat dhe kompensimet e Sekretarit të Përgjithshëm dhe e stafit tjetër të IAP-së, deri në aprovimin e Ligjit për pagat nga Buxheti i Republikës së Kosovës, përcaktohen me akt të veçantë nga ana e Avokatit të Popullit.

Neni 26

Orari i punës dhe pranimit e palëve

1. Orari i punës së IAP-së, si dhe orarit i punës së pranimit të qytetarët rregullohet me akt nënligjor të veçantë.
2. Koha e përcaktuar për pranimin e qytetarëve postohet në vend të dukshëm në hyrje të objektit të selisë së IAP-së, në të gjitha zyrat rajonale zyrës të IAP-së dhe në ueb faqen e IAP-së.
3. Qytetarët i pranojnë Avokati i Popullit, zëvendësit e Avokatit të Popullit dhe këshilltarët juridikë.
4. Në rastin kur ankuesi nuk ka caktuar takim, ai do ta realizojë takimin me këshilltarët juridikë të IAP-së të caktuar nga Avokati i Popullit apo zëvendësit e Avokatit të Popullit.

Neni 27

Marrëdhëniet me publikun

1. Puna e IAP-së është e hapur për publikun dhe publikut i ofrohet qasje në të përmes:
 - 1.1 informimit për datën dhe kohën e mbajtjes së takimeve të Avokatit të Popullit;
 - 1.2 komunikatave për shtyp të dërguara mediave pas miratimit të përmbajtjes së tyre nga Avokati i Popullit;
 - 1.4 konferencave për shtyp;
 - 1.5 publikimit të vendimeve;
2. Avokati i Popullit do të informojë publikun për punën e tij nëpërmjet raporteve të rregullta vjetore ose të veçanta, përmes prezantimit të punës së tij në konferencat për shtyp, komunikata për shtyp, duke publikuar raporte dhe propozime në masmedia e tij dhe në botime të veçanta.
3. Informatat për pranimin, shqyrtimin dhe hetimin e ankesave, draft rekomandimet, draft vendimet dhe çfarëdo njoftimesh të bëra nga zyrtarët e IAP-së, gjatë procedurës përgatitore dhe shqyrtimit paraprak të kërkesave, përveç parashtruesve të kërkesave, nuk u vihen në dispozicion publikut për të pasur qasje në to.
4. Personat e tjerë kanë qasje në dokumente të IAP-së në pajtim me Ligjin për Qasje në Dokumentet Zyrtare.

5. Te punësuarit e IAP-së duhet t'i respektojë rregullat për sigurimin e fshehtësisë së të dhënave dhe konfidencialitetin e procedurës, në përputhje me Ligjin për Avokatin e Popullit dhe ligjet përkatëse në fuqi.

Neni 28

Kodi i etikës

1. Kodi i etikës për punonjësit e Institucionit të Avokatit të Popullit, përcakton standardet e etikës profesionale të sjelljes gjatë kryerjes së misionit të tyre.
2. Kodi i etikës miratohet me vendim të Avokatit të Popullit dhe publikohet në ueb faqen zyrtare të institucionit.

Neni 29

Ngritja e kapaciteteve

1. Personeli i IAP-së duhet të zhvillojë në mënyrë të vazhdueshme aftësitë dhe kapacitetet lidhur me mbrojtjen, mbikëqyrjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut, për të siguruar në kohë dhe në mënyrë efektive mbështetjen profesionale dhe administrative për Avokatin e Popullit.
2. IAP aprovon një dokument të posaçëm mbi politikën e ngritjes së kapaciteteve, trajnimit dhe aftësimin të stafit, mbi bazën e së cilit do të miratohet dhe zbatohet Programi i trajnimeve për arritje të objektivave të punës së IAP-së.

Neni 30

Regjistrat

1. IAP mbanë dy lloje të regjistrave-regjistrat administrativ dhe regjistrat lidhur me pranimin dhe hetimin e ankesave:
 - 1.1. Regjistrat administrativ, të cilët u nënshtrohen rregullave dhe procedurës së parashikuar me Ligjin Nr.04/L-184 për Administrimin e Punës në Zyrë dhe Ligjit Nr.04/-088 për Arkivat Shtetërore, janë të hapur për publikun, me disa përjashtime dhe përfshijnë administrimin e dokumenteve zyrtare që nga evidentimi fillestar deri në procedimin përfundimtar të tyre dhe arkivimin, siç mundë të jenë të dhënat dhe statistikat për buxhetin, shënimet për personelin, që zakonisht janë konfidenciale, korrespondenca adresuar IAP-së dhe korrespondenca nga IAP, jo për ankesat apo hetimet dhe indeksi për t'i bërë këto dosje të qasshme.

- 1.2. Regjistrat lidhur me pranimin dhe hetimin e ankesave, janë konfidenciale dhe nuk janë të hapura për publikun dhe përfshijnë këto të dhëna:
- 1.2.1 formularët e pranimit;
 - 1.2.2 shënimet dhe dosjet e hetuesit lidhur me hetimin;
 - 1.2.3. dokumentet e kopjuara lidhur me hetimin;
 - 1.2.4. shiritat dhe transkriptet e dëshmisë së marrë lidhur me ankesën;
 - 1.2.5. çfarëdo kopje tjetër e informatave apo dëshmisë lidhur me ankesën;
 - 1.2.6. draftet e raporteve hetuese dhe korrespondencës lidhur me ankesën;
 - 1.2.7. çfarëdo indeksi në këto dosje.

Neni 31

Ruajtja e të dhënave

1. Avokati i Popullit përcakton politiken e hapjes dhe të ruajtjes së regjistrave në IAP, përfshirë mënyrat e dokumentimit të të dhënave, oraret e ndryshme gjatë të cilëve regjistrat ose do të arkivohen ose shkatërrohen.
2. Arkivimi duhet të jetë funksional, të përfshijë një indeks sistem dhe regjistrat duhet të ruhen për periudhën kohore për të cilën ka mundësi se ato dosje do të jenë të nevojshme.

Neni 32

Letërnjoftimi zyrtar

1. Avokati i Popullit, zëvendës Avokatët e popullit dhe nëpunësit e autorizuar të IAP-së bartin letërnjoftimin zyrtar.
2. Përmbajtja dhe forma e letërnjoftimit, mënyra e lëshimit, e evidentimit dhe e përdorimit, specifikohen me Vendim të veçantë të miratuar nga Avokati i Popullit.

KAPITULLI IV

PROCEDURA E BRENDSHME

Neni 33

Rregulli i përgjithshëm

1. Dispozitat procedurale te kësaj pjese zbatohen ndaj të gjitha procedurave para IAP-së të cilat zhvillohen lidhur me kërkesat dhe ankesat që i paraqiten IAP-së sipas Ligjit për Avokatin e Popullit, përveç nëse përcaktohet ndryshe me ndonjë rregullore tjetër apo udhëzim të posaçëm administrativ nga Avokati i Popullit.
2. Në rast të mungesës së dispozitave procedurale, IAP mund të zbatoi në mënyrë të arsyeshme dhe analoge dispozitat përkatëse të ligjeve të tjera procedurale duke marrë parasysh natyrën e çështjes si dhe specifikat e procedurës para IAP-së lidhur me mbrojtjen, mbikëqyrjen dhe promovimin e të drejtave dhe lirive themelore të personave fizikë dhe juridikë nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike, institucioneve dhe personave apo autoriteteve tjera të cilët ushtrojnë autorizime publike në Republikën e Kosovës.

NËNKAPITULLI I

PRANIMI DHE SHQYRTIMI I ANKESAVE

Neni 34

Parashtrimi i ankesave dhe fillimi i procedurës

1. Ne përputhje me nenin 19 të Ligjit për Avokatin e Popullit, çdo person i cili pretendon se të drejtat apo liritë e tij janë shkelur me ndonjë ligj, veprim apo mosveprim, keqadministrim të autoriteteve, mund të parashtrojë ankesë dhe të kërkojë nga Institucioni i Avokatit të Popullit fillimin e procedurës.
2. IAP pranon ankesat në mënyrën se si ankuesi dëshiron t'i paraqes ato, përfshi vizitat personale në zyrën qendrore dhe në zyrat rajonale, dërgimin nëpërmjet postës, emailit apo nëpërmjet faksit në adresë të IAP-së, kutive të ankesave, apo edhe nëpërmjet thirrjeve telefonike.
3. Procedura para IAP-së fillon me dorëzimin e ankesës, sipas procedurës së përcaktuar me këtë rregullore, në Zyrën Qendrore të Pranimit apo në zyrat e Avokatit të Popullit në qendrat rajonale.
4. Pasi të jetë dorëzuar ankesa, apo çfarëdo dokumenti fillestar, ankesës i caktohet numri i regjistrimit të saj nga departamenti përkatës i IAP-së për pranimin e ankesave dhe administrimin e tyre.

Neni 35

Pranimi i ankesave dhe shpërndarja e tyre

1. Ne selinë e IAP-së në Prishtinë, ankesat lidhur me shkeljet e pohuara të të drejtave të njeriut, duke përfshirë veprimet apo mosveprimet që paraqesin keqpërdorim të

autoritetit, pranohen nga Zyra Qendrore e Pranimit, e cila vepron përbrenda departamentit përgjegjës për pranimin e ankesave.

2. Ankesat pranohen po ashtu edhe nga të gjitha zyrat e Avokatit të Popullit në qendrat rajonale, të cilat përcillen dhe regjistrohen në zyrën qendrore në Prishtinë për procedim të mëtejshëm.
3. Brenda 24 orëve nga koha e mbërritjes dhe regjistrimit në IAP, Avokati i Popullit, duhet të bëjë shpërndarjen e kërkesave, ankesave apo njoftimeve, duke përcaktuar sektorin, përkatësisht departamentin përkatës në kompetencën e të cilit është ndjekja e çështjes.
4. Në rastet e mungesës së Avokatit të Popullit, shpërndarjen e bën zëvendësi kryesor i Avokatit i Popullit ose njëri nga zëvendësit e Avokatit të Popullit i caktuar prej tij.

Neni 36

Format e parashtrimit të ankesave

1. Personat fizikë dhe juridikë, të cilët dëshirojnë të nisin procedurën para IAP-së, lidhur me fillimin e procedurës për shqyrtimin dhe hetimin e ankesës, paraqesin ankesën e tyre në formë të shkruar apo me gojë në njërën nga gjuhët zyrtare në Kosovë ose në njërën nga gjuhët me përdorim zyrtar në Kosovë.
2. Personat që nuk janë në gjendje të paraqesin një ankesë me shkrim lejohen ta paraqesin atë me gojë dhe në këtë rast këshilltari juridik i pranimit të ankesës do të marrë shënim ankesën, kërkesën apo njoftimin e bërë, duke bërë shënimin se personi që e paraqet ankesën nuk di të shkruajë, të njëjtën do ta firmojë vetë në prani të një personi tjetër.

Neni 37

Përmbajtja e ankesës

1. Në pajtim me nenin 20 të Ligjit për Avokatin e Popullit, çdo ankesë për fillimin e procedurës, si rregull paraqitet me shkrim personalisht në selinë e IAP-së ose në zyrat rajonale të IAP-së gjatë orarit të rregullt të punës.
2. Kërkesa për fillimin e procedurës mund të paraqitet në mënyrë elektronike edhe gojarisht, në rast se nuk mund të bëhet me shkrim.
3. Çdo ankesë që i parashtrohet Avokatit të Popullit duhet të jetë e nënshkruar dhe t'i ketë se paku këto të dhëna:
 - 3.1. shënimet personale të paraqitësit të ankesës;
 - 3.2. të përmbajë të gjitha rrethanat, faktet dhe dëshmitë në të cilat kjo ankesë bazohet dhe

- 3.3. deklarin nga paraqitësi i ankesës nëse mjetet juridike janë ushtruar apo jo, dhe nëse po cilat prej këtyre mjeteve janë zbatuar.
4. IAP siguron formularët e kërkesës për palët për të dorëzuar ankesat e tyre, dhe të njëjtit i vendos në dispozicion në ueb faqen e IAP-së.

Neni 38

Formulari i ankesës

1. Formulari i ankesës duhet të përmbajë këto të dhëna dhe informata:
 - 1.1. Të dhënat personale të ankuesit dhe adresën e vendbanimit, si dhe kontaktet e tij/saj;
 - 1.2. Organin shtetëror, organin e pushtetit lokal, apo organin e besuar të autoritetit publik të cilit i referohet ankesa;
 - 1.3. Përmbledhjen dhe përshkrimin e shkeljeve të pohuara të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, duke përfshirë veprimet apo mosveprimet që paraqesin keqpërdorim të autoritetit;
 - 1.4. Faktet, dëshmitë, informacionet dhe kopjet e çfarëdo dokumenti relevant në të cilat bazohet ankesa;
 - 1.5. Çdo lloj dokumenti zyrtar, origjinal ose fotokopje, në të cilët mbështetet ankesa;
 - 1.6. Të përmenden autoritetet publike të cilat janë njoftuar më parë me rastin dhe nëse objekti i kërkesës është në gjykim e sipër;
 - 1.8. Provat e vonesës ose të refuzimit të organit kompetent për të zgjidhur kërkesën apo ankesën në afatin e parashikuar sipas ligjit;
 - 1.9. Përshkrimi i mjeteve juridike të cilat janë zbatuar më parë në rastin konkret;
 - 1.10. Në rast se ankesa paraqitet prej avokatit ose ndonjë personi tjetër përfaqësues, ankesës duhet t'i bashkëngjitet autorizimi përkatës;
2. Dokumentet mund të parashtrihen në cilëndo gjuhë zyrtare të Kosovës, ose në ndonjërin nga gjuhët në përdorim zyrtar në Kosovë. Në rastet kur dokumenti që i është bashkëngjitur kërkesës nuk është në njërin nga gjuhët zyrtare, ose në gjuhët në përdorim zyrtar, atëherë ai duhet të jetë i shoqëruar nga përkthimi i certifikuar në njërin nga këto gjuhë.

Neni 39

Procedura pas pranimit të ankesës dhe regjistrimi

1. IAP regjistron menjëherë të gjitha ankesat e pranuar në regjistrin e IAP-së sipas radhës në të cilën janë parashtruar.
2. IAP-i mban një listë kontrolluese të dokumenteve të nevojshme dhe mund të ndihmojë parashtruesit e ankesave, duke sqaruar dhe shpjeguar se çfarë mungon në kërkesë, me rastin e paraqitjes së saj.
3. Ankesat duhet të jenë të kompletuara dhe arsyetuara dhe se atyre duhet t'iu bashkëngjiten dokumentacioni përkatës i nevojshëm siç specifikohet në Formularin e Ankesës, bashkëlidhur kësaj rregulloreje në formën e Aneksit 1.
4. IAP mban regjistrin me të dhënat përkatëse të cilat regjistrohen me rastin e parashtrimit të ankesës, siç janë:
 - 4.1. data e pranimit të ankesës;
 - 4.2. numri i dosjes së rastit për të identifikuar ankesën specifike të parashtruar;
 - 4.3. emrin e ankuesit, gjininë, adresën, qytetin, shtetin, numrin e telefonit përfshirë këtu edhe kodin postal të qytetit;
 - 4.4. informata tjera për kontakt siç janë numri i faksit apo telefonit celular, e-mail adresa;
 - 4.5. numrin e letërnjoftimit apo pasaportës nëse një gjë e tillë është e nevojshme për të qenë në gjendje për të ekzaminuar ankesën.
 - 4.6. mënyra e kontaktimit me zyrën, emrin e organit apo institucionit kundër të cilit parashtrohet ankesa.
 - 4.7. një përmbledhje e shkëlqeve të pohuara të të drejtave të njeriut apo veprime të tjera që janë subjekt i kompetencave të IAP-së.
 - 4.8. departamentin përgjegjës për të trajtuar ankesën si dhe
 - 4.9. këshilltarin juridik përgjegjës të caktuar për shqyrtimin e ankesës.
5. Përveç informative që identifikojnë ankuesin dhe sigurojnë specifikat lidhur me ankesën, këshilltarët juridikë përgjegjës do të kërkojnë nga ankuesit të sigurojnë çfarëdo dokumentacioni lidhur me ankesën të cilat i posedon ankuesi, siç janë letra, vendime ose dokumente të tjera, të cilat gjithashtu përfshihen në regjistrin përkatës.
6. IAP i cakton numër të veçantë secilës kërkesë.
7. Për secilën kërkesë IAP-i krijon nga një dosje, e cila përmban të gjitha dokumentet dhe materialet e ndërlidhura me kërkesën, si dhe dokumentet dhe materialet e tjera të krijuara gjatë procedurës së shqyrtimit.

Neni 40

Përcaktimi i këshilltarit juridik përgjegjës

1. Pas regjistrimit të kërkesës, drejtori i departamentit përgjegjës për pranimin e ankesave cakton njërin prej këshilltarëve juridikë për shqyrtimin paraprak të ankesës,

kompletimin dhe përgatitjen e dokumentacionit siç është specifikuar në nenin 39 të kësaj rregulloreje, përkatësisht formularin për parashtrimin e ankesës.

2. Drejtori i departamentit siguron shpërndarjen e barabartë të ankesave dhe kërkesave të këshilltarët juridikë.

Neni 41

Përjashtimi i këshilltarit juridik përgjegjës

1. Me rastin e pranimit të ankesës për vlerësim paraprak, këshilltari juridik përjashtohet nga pjesëmarrja në procedurë, sipas detyrës zyrtare ose me kërkesë të parashtruesit të ankesës, kur është i përfshirë në çështjen e cila është objekt shqyrtimi nga ana e tij.
2. Këshilltari juridik, i cili ka njohuri se plotëson kushtet për përjashtim nga procedura, ka për detyrë ta njoftojë me shkrim Avokatin e Popullit dhe të kërkojë përjashtimin e tij nga procedura.
3. Këshilltari juridik nuk duhet të marrë pjesë apo trajtojë ankesa poqë se paraqitet konflikti i interesit, siç përcaktohet nga Ligji Nr. 03/L-155 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 2/L-133 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.
4. Vendimi për përjashtimin e këshilltarit juridik merret nga Avokati i Popullit dhe duhet të jetë i arsyetuar.

Neni 42

Shqyrtimi paraprak nga këshilltari juridik

1. Këshilltari juridik përgjegjës, i merr të dhënat lidhur me ankesat gjatë kontaktit të parë ndërmjet IAP-së dhe individit i cili ankohet:
 - 1.1. Bën identifikimin e ankuesit duke kërkuar identitetin e personit-emrin e ankuesit, adresën, numrin e telefonit dhe çfarëdo informate tjetër të rëndësishme që mund të ndihmojë shqyrtimin paraprak të ankesës.
 - 1.2. Bën identifikimin e organit, institucionit apo zyrtarit përgjegjës i cili është subjekt i ankesës së personit.
 - 1.3. Identifikon veprimet ndaj të cilave IAP ka kompetencë, për të përcaktuar nëse mund të hetojë ankesën dhe nëse çdo gjë mund të bëhet me ankesën.
 - 1.4. Identifikon veprimet të cilat ankuesi dëshiron që të ekzaminohen nga IAP.
2. Këshilltari juridik përgjegjës, së bashku me pranimin e ankesës, do të bëjë përcaktime fillestare nëse ankesat janë brenda kompetencave të IAP-së apo nëse subjekti i ankesës është i tillë që duhet të drejtohet tek ndonjë organ apo institucion tjetër.

3. Këshilltari juridik përgjegjës do të përcaktojë nëse ankesa është në kompetencë të IAP-së, për çfarë lloji të shkeljes së të drejtave pohon ankuesi dhe cilat standarde duhet të zbatohen për të përcaktuar se a ka ankesa vlefshmëri dhe si të ankimohet ankesa.
4. Në rastet kur ankesa e individit nuk është brenda kompetencave të IAP-së, këshilltari juridik i pranimit të ankesave do të ofrojë ndihmën e përshtatshme ose informata dhe mund ta drejtojë personin tek institucioni apo organi që ka kompetencë për t'u marrë me çështjen e ankuesit. Në këto raste, identiteti, adresa dhe thelbi i ankesës, së personit shënohen, gjithashtu në regjistrin e të dhënave.
5. Këshilltari juridik përgjegjës mund t'u ndihmojë individëve të cilët kanë ndonjë ankesë të kuptojnë procedurat e ankimit, të cilat mund t'i ndjekin dhe si t'i bëjnë ato të dobishme ose të ndërmarrin veprimet të cilat mund të zgjedhin ankesat e tyre.
6. Këshilltari juridik përgjegjës ka për detyrë të dëgjojë ankuesit, t'u ndihmojë ta kuptojnë situatën me të cilën po ballafaqohen dhe të kuptojnë ligjet dhe rregulloret të cilat mund t'i zbatojnë, si dhe të kuptojnë rolin e Avokatit të Popullit.
7. Këshilltari juridik përgjegjës ndihmon ankuesit gjatë intervistimit për të identifikuar shkaqet rrënjësore të shqetësimeve të tyre dhe për të vlerësuar nëse ka hapësirë për ankesë apo mënyrë tjetër alternative për të zgjidhur ankesën e tyre.
8. Këshilltaret përgjegjës të pranimit nuk do të duhej t'i premtinin asnjë ankuesi, qoftë ai i shoqëruar nga të tjerët apo jo, çfarë veprimesh do të ndërmerren ose nuk do të ndërmerren lidhur me ankesën.

Neni 43

Verifikimi dhe kompletimi i ankesave

1. Këshilltari juridik përgjegjës njëkohësisht bën verifikimin nëse ankesa dhe dokumentacioni i bashkëlidhur është kompletuar sipas procedurës dhe kriterëve të përcaktuara me këtë rregullore.
2. Në rast se ankesa nuk është plotësisht e qartë dhe e kompletuar, përkatësisht nuk përmban të dhënat e nevojshme për procedim, këshilltari juridik ka të drejtë të kërkojë dokumente shtesë, për të krijuar një përmbledhje të shkurtë lidhur me pohimet e ankuesit dhe për të vlerësuar pranueshmërinë dhe bazueshmërinë e kërkesës.
3. Në rastet e paqartësive dhe moskompletimit të ankesës, këshilltari juridik përgjegjës njofton parashtruesin e ankesës dhe ia cakton një afat prej shtatë (7) ditëve për të qartësuar ose plotësuar ankesën, përkatësisht përgjigjen në kërkesë.
4. Po qe se ankuesi në afatin e caktuar nuk vepron sipas kërkesës nga paragrafi 2 i këtij neni, përkatësisht ka dështuar të sigurojë informatat e kërkuara nga Avokati i Popullit, do të konsiderohet se ka hequr dorë nga ankesa dhe Avokati i Popullit mund të vendosë të mos e vazhdojë më shqyrtimin e ankesës dhe të hedh poshtë ankesën, siç përcaktohet me paragrafin 1.3.5, të nenit 21, të Ligjit për Avokatin e Popullit.

5. Brenda katërmbëdhjetë (14) ditëve nga pranimi i kërkesës dhe përgjigjes në kërkesë këshilltari juridik ia dërgon drejtorit të departamentit draft raportin paraprak me rekomandimin përkatës për hedhje poshtë të ankesës.

Neni 44

Ankesat anonime

1. Me nenin 20 të Ligjit për Avokatin e Popullit, është përcaktuar që çdo ankesë që i parashtrahet Avokatit të Popullit, në zyrën qendrore në Prishtinë, në zyrat rajonale apo në Ditët e Hapura, duhet të jetë e nënshkruar dhe t'i ketë shënimet personale të paraqitësit të ankesës.
2. IAP nuk pranon ankesa ose kërkesa anonime, të cilat parashtrihen drejtpërsëdrejti në Zyrat e IAP-së, apo dërgohen nëpërmjet postës, emailit, nëpërmjet faksit apo edhe nëpërmjet thirrjeve telefonike, nga personat të cilët nuk tregojnë identitetin e tyre.
3. Në raste të tilla pas verifikimeve përkatëse, ankesa konsiderohet anonime dhe nuk merret në shqyrtim, por do të arkivohet.
4. Këshilltari juridik përgjegjës, që bën arkivimin, paraprakisht duhet të vërë në dijeni drejtorin e departamentit, për të parë nëse janë bërë të gjitha përpjekjet e duhura për të kontaktuar ankuesin para se të merret vendimi për arkivim.

Neni 45

Papranueshmëria e shqyrtimit të ankesës

1. Nëse departamenti përkatës vjen në përfundim se kërkesa nuk i plotëson kushtet formale për procedim të mëtutjeshëm dhe për këtë shkak nuk është e pranueshme, për shkaqet e nënvizuar në nenin 21, paragrafi 1.3, të Ligjit për Avokatin e Popullit, drejtori i departamentit ia dërgon zëvendësit të Avokatit të Popullit propozim vendimin, i cili duhet të përmbajë arsyet për papranueshmërinë e kërkesës, me të cilin hidhet poshtë kërkesa për shkak të mungesës së pranueshmërisë.
2. Zëvendësi i Avokatit të Popullit shqyrton kërkesat, duke u nisur nga rekomandimet dhe këshillat teknike nga raporti paraprak i përgatitur nga departamenti përkatës, përkatësisht këshilltari juridik.
3. Propozim vendimi, për papranueshmërinë e kërkesës, nga ana e zëvendësit të Avokatit të Popullit, me vlerësimin përkatës, i përcillet menjëherë Avokatit të Popullit për shqyrtim të mëtejshëm dhe vendosje.
4. Në përputhje me nenin 21, paragrafin 2 të Ligjit për Avokatin e Popullit, brenda tridhjetë (30) ditësh nga dita e pranimi të ankesës për shqyrtim, Avokati i Popullit e nënshkruan dhe e shpall vendimin me të cilin hidhet poshtë ankesa për shkak të

mungesës së lejueshmërisë, siç përcaktohet në paragrafin 1.3 të nenit 21 të Ligjit për Avokatin e Popullit.

5. Në të gjitha rastet e vendosjes, siç janë përcaktuar me nenin 21, paragrafi 1 të Ligjit për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit e njofton me shkrim palën brenda tridhjetë(30) ditësh nga dita e pranimit të ankesës.

Neni 46

Refuzimi i shqyrtimit të ankesës

1. Nëse departamenti përkatës vjen në përfundim se kërkesa nuk i plotëson kushtet formale për procedim të mëtutjeshëm për arsyet e përcaktuara në nenin 22, paragrafi 1, të Ligjit për Avokatin e Popullit, brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve pune, drejtori i departamentit ia dërgon zëvendës Avokatit të popullit propozim-vendimin, për refuzimin e shqyrtimit të ankesës.
2. Propozim-vendimi, për refuzimin e shqyrtimit të ankesës, nga ana e zëvendësit të Avokatit të Popullit, me opinionin përkatës i përcillet menjëherë Avokatit të Popullit për shqyrtim të mëtejshëm dhe vendosje.
3. Brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita e pranimit të ankesës, Avokati i Popullit e njofton me shkrim palën për refuzimin e shqyrtimit të ankesës.
4. Me rastin e refuzimit të ankesës, Avokati i Popullit duhet të japë arsyetim për shkaqet e refuzimit, përveç në rastet kur pala e kundërshton këtë shprehimisht.

Neni 47

Forma e prerë e ankesës

Bazuar në nenin 22, paragrafin 2 të Ligjit për Avokatin e Popullit, vendimi i Avokatit të Popullit për të hedhur poshtë apo për të refuzuar ankesën është i formës së prerë dhe nuk mund të ushtrohen mjetet e rregullta dhe/apo të jashtëzakonshme juridike.

Neni 48

Rastet e parashkrimit dhe përjashtimit

1. Sipas nenit 23 të Ligjit për Avokatin e Popullit, nëse prej datës që pala e ka marrë vendimin e formës së prerë apo është njoftuar lidhur me të dhe deri në dorëzimin e ankesës në IAP kanë kaluar më shumë se tri (3) vite, IAP nuk do të iniciojë procedurë për të hetuar shkeljen e të drejtave të njeriut.
2. Përjashtimisht nga paragrafi 1 i këtij neni, IAP mund të iniciojë procedurë edhe pas kalimit të afatit prej tri (3) vitesh në rast se Avokati i Popullit vlerëson se paraqitësi i

ankesës ka qenë i penguar, në rast se shkelja është duke vazhduar, apo në rast se Avokati i Popullit vlerëson se çështja është e rëndësisë së veçantë.

3. Këshilltari juridik, i cili bën pranimin e ankesës fillimisht do të verifikojë datën e marrjes së vendimit të formës së prerë apo të njoftimit për ankuesin dhe në rast se konstaton që kanë kaluar më shumë se tri (3) vite deri në dorëzimin e ankesës në IAP, do të njoftojë parashtruesin e ankesës dhe do të propozojë mos inicimin e procedurës, duke përjashtuar rastet e përshkruara si në paragrafin 2 të këtij neni.
4. Në përputhje me nenin 21, paragrafin 2 të Ligjit për Avokatin e Popullit, brenda tridhjetë (30) ditësh nga dita e pranimin të ankesës për shqyrtim, Avokati i Popullit e njofton me shkrim palën për hedhjen poshtë të ankesës për shkak të parashkrimit dhe përjashtimit, siç përcaktohet në paragrafin 1.3.2, të nenit 21, të Ligjit për Avokatin e Popullit.

Neni 49

Veprimi me ankesën e përsëritur

1. Nëse ankuesi përsëri parashtron ankesë, e cila në raport me ankesën e mëhershme të parashtruar nuk përmban rrethana, fakte dhe prova të reja, Avokati i Popullit do të konsiderojë ankesën e tillë të vendosur.
2. Avokati i Popullit njofton parashtruesin e ankesës lidhur me arsyet e përmendura në paragrafin 1 të këtij neni, për shkak të së cilave ankesa e parashtruar konsiderohet e vendosur.

Neni 50

Veprimi sipas ankesave

1. Avokati i Popullit është i lirë të vendosë nëse janë plotësuar kushtet dhe kriteret për shqyrtim të një ankese dhe deri në çfarë mase.
2. Kur vendoset nëse një ankesë do të merret në shqyrtim dhe deri në çfarë mase, IAP në veçanti do të ketë parasysh:
 - 2.1. Rëndësinë dhe vlerën e të mirave materiale të dëmtuara dhe të shkelura apo që mundë të jenë të dëmtuara dhe të shkelura;
 - 2.2. Mundësinë e shkeljeve të të drejtave të në numri të madh të njerëzve;
 - 2.3. Mënyrat dhe rrethanat në të cilat kanë ndodhur apo mund të shkelen të drejtat e garantuara me kushtetutë dhe ligj.
 - 2.4. Mundësitë e tjera ligjore për mbrojtjen e të drejtave të rrezikuara.

Neni 51

Tërheqja e ankesës

1. Parashtruesi i ankesës mund ta tërheqë ankesën dhe dokumentacionin e bashkëlidhur në çdo kohë të procedimit para marrjes së vendimit nga Avokati i Popullit.
2. Avokati i Popullit e njofton autoritetin përgjegjës të përfshirë në ankesë, lidhur me tërheqjen e ankesës.
3. Pavarësisht tërheqjes së kërkesës, Avokati i Popullit mund të përcaktojë të vendosë përkitazi me të.
4. Në rast të tillë, Avokati i Popullit vendos, duke u bazuar vetëm në ankesën e parashtruar dhe arsyetimin e saj, si dhe në çfarëdo dokumentesh që i janë bashkëngjitur asaj deri në momentin e dorëheqjes nga parashtruesi.

NËNKAPITULLI II

PRANUESHMËRIA E ANKESAVE DHE PROCEDURA E HETIMIT TË I TYRE

Neni 52

Pranueshmëria e ankesës

1. Në rastet kur Departamenti përgjegjës për pranimin dhe administrimin e ankesave konstaton se ankesa është e pranueshme dhe se çështja kërkon fillimin e hetimit të plotë, kërkesa me të gjitha shkresat e pranuar, brenda afatit prej shtat (7) ditësh i përcillet në procedurë të mëtejme Departamentit përgjegjës për zhvillimin e hetimeve.
2. Departamentit përgjegjës për zhvillimin e hetimeve në afatin prej shtat (7) ditësh, bazuar në raportin e pranuar me rekomandimin përkatës, përgatit propozim vendimin për fillimin e hetimit, të cilin nëpërmjet zëvendësit të Avokatit të Avokatit, ia përcjell Avokatit të Popullit për miratim.
3. Vendimi për fillimin e hetimeve duhet të përmbajë:
 - 3.1. Objektin e ankesës së parashtruar, përcaktimin e organit përgjegjës kompetent dhe zyrtarët që do të intervistohen lidhur me ankesën e parashtruar;
 - 3.2. Faktet, dokumentet dhe dëshmitë e pranuar nga ankuesi të cilat do t'i nënshtrohen verifikimit dhe hetimit;
 - 3.3. Këshilltarët juridik që do të zhvillojnë hetimin dhe përgatisin raportin me rekomandimin përkatës;
 - 3.4. Afatet brenda së cilave duhet kryer veprimet e nevojshme;

Neni 53

Procedura pas fillimit të hetimit dhe njoftimi i palës

Kur Avokati i Popullit vendos të fillojë hetimin e plotë, siç është përcaktuar në nenin 21, paragrafin 1.2 të Ligjit për Avokatin e Popullit, vendimin e vet do t'ia komunikojë paraqitësit të ankesës, brenda tridhjetë (30) ditësh pune nga dita e pranimit të ankesës, në përputhje me nenin 21, paragrafin 2 të Ligjit për Avokatin e Popullit.

Neni 54

Komunikimi me autoritetet dhe zyrtarët përgjegjës

1. Kur Avokati i Popullit vendosë për zhvillimin e hetimeve të mëtejshme, përveç ankuesit, sipas vlerësimit të tij, vendimin e vet do t'ia komunikoi në një kohë të arsyeshme edhe autoritetit kundër të cilit është paraqitur ankesa, por jo më gjatë se tridhjetë (30) ditë pune nga dita e pranimit të ankesës.
2. Në përputhje me nenin 24.2 të Ligjit për Avokatin e Popullit, pas njoftimit të autoritetet përgjegjës për pranueshmërinë e rastit, mund të kërkojë nga ta që brenda afatit të përcaktuar ligjor, jo më shkurt se tetë (8) ditë dhe as më gjatë se tridhjetë (30) ditë pune, të dorëzojnë informata me shkrim dhe dokumente specifike që kanë të bëjnë me rastin.
3. Nëse vazhdon dëmi i rëndë, si pasojë e ankesës së parashtruar, sipas paragrafit 1, të nenit 16, të Ligjit për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit ndërmerr të gjitha masat dhe veprimet e nevojshme, duke kërkuar nga autoritetet kompetente përgjigjen me nguti.

Neni 55

Afati i kryerjes së hetimeve

1. Nga momenti i hapjes së hetimeve, në parim dhe si rregull, afati i kryerjes së hetimeve, nuk duhet t'i kalojë tre (3) muaj.
2. Pasi të fillojë muaji i shtatë (7), departamenti përkatës dhe zëvendësi i Avokatit të Popullit, duhet të njoftojnë me shkrim Avokatin e Popullit, me arsyet se përse rasti nuk është përfunduar brenda gjashtë (6) muajve dhe njëkohësisht për çdo muaj e deri në përfundim të rastit, duhet të merret pëlqimi i tij për vazhdimin e hetimeve.

Neni 56

Ndërprerja e hetimeve

1. Avokati i Popullit ndërpret hetimet e mëtejshme sipas ankesës, jo vetëm në rastet kur konstaton se rasti është zgjidhur në ndonjë mënyrë tjetër në pajtim me kërkesën e ankuesit, siç parashikohet me nenin 21, paragrafi 1.5 të Ligjit për Avokatin e Popullit, por edhe kur organi përgjegjës gjatë procedurës eliminon shkeljen e të drejtave dhe lirive të njeriut, ose arrihet marrëveshja ndërmjet paraqitësit/ankuesit dhe palës përgjegjëse/organit kompetent.
2. Me ndërprerjen e hetimit përfundon procedura e vazhimit të zhvillimit të hetimeve.
3. Ndërprerja e procedurës së hetimit, në afatin prej shtatë (7) ditësh i komunikohet ankuesit ose kërkuesit, si dhe autoriteteve kompetente ndaj të cilave janë zhvilluar hetimet.
4. Në njoftimin lidhur me ndërprerjen e procedurës së hetimit sipas paragrafit 1 të këtij neni, Avokati i Popullit, ndër të tjera do të specifikojë arsyet e ndërprerjes së procedurës.

Neni 57

Sigurimi i informacioneve relevante

1. Në përputhje me nenin 18, paragrafi 7 të Ligjit për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit, zëvendësi i Avokatit të Popullit ose përfaqësuesit e tij, kur ushtrojnë detyrat e tyre jashtë selisë së IAP-së, mund të hyjnë në të gjitha hapësirat zyrtare të të gjitha autoriteteve të Republikës së Kosovës, duke paraqitur kartën e identitetit zyrtar, për të siguruar informacione relevante, lidhur me rastet që i ka në shqyrtim.
2. Avokati i Popullit ose përfaqësuesi i tij, për përmbushjen e detyrave të tij, nga të gjitha autoritetet publike, mund të kërkojnë të njohin çdo informacion, përfshirë edhe kopjen e plotë apo të pjesshme të dosjes, dokumentet ose aktet e mbajtura nga institucionet publike në lidhje me ankesat e personave të cilëve iu janë cenuar të drejtat dhe liritë e tyre, në masën që konsiderohet e nevojshme për zgjidhjen e çështjes dhe në respektim të plotë të konfidencialitetit të të dhënave.
3. Në rastin kur pengohen të hyjnë në hapësirat zyrtare vihet në dijeni Avokati i Popullit, i cili përcakton se si do të zgjidhet një situatë e tillë.

Neni 58

Kërkesat për bashkëpunim dhe pasojat e refuzimit

1. Në përputhje me nenin 25 të Ligjit për Avokatin e Popullit, të gjitha autoritetet kanë për obligim që në afatet ligjore të caktuara, t'i përgjigjen Avokatit të Popullit në kërkesat e tij për zhvillimin e hetimeve, si dhe t'i ofrojnë bashkëpunimin dhe ndihmën adekuate të kërkuar.

2. Në rastet kur institucioni dhe/apo zyrtari përgjegjës nuk ndërmerr masat e nevojshme, refuzon të bashkëpunojë ose ndërhyjë në procesin e hetimit, departamenti përkatës i zhvillimit të hetimeve, do të propozojë iniciimin e procedurës, kurse Avokati i Popullit do të kërkojë nga organi kompetent:
 - 2.1. marrjen e masave disiplinore ndaj zyrtarit përgjegjës;
 - 2.2. fillimin e procedurës ligjore nga prokurori, për pengimin e kryerjes së detyrës zyrtare;
 - 2.3. procedimin e çështjes tek organi më i lartë kompetent, si dhe
 - 2.4. t'i paraqesë raport të veçantë Kuvendit, duke i propozuar edhe masa konkrete për vënien në vend të së drejtës së shkelur.

Neni 59

Ndihma për Avokatin e Popullit

Në çdo fazë të zhvillimit të procedurës së një ankese, në përputhje me nenin 26 të Ligjit për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit mund t'i dërgojë thirrje çdo dëshmitari ose ekspertit për ta intervistuar lidhur me rastin, si dhe të kërkojë ndihmën përkatëse nga cilido person i cili mund të ndihmojë në shqyrtimin e plotë të ankesës së parashtruar apo zgjidhjen e rastit të iniciuar nën hetim.

Neni 60

Procedura pas hetimeve

1. Pas kryerjes së hetimeve, departamenti përkatës për zhvillimin e hetimeve, përgatit raportin me rekomandimet përkatëse rreth masave që duhen ndërmarr nga organi përgjegjës për zgjidhjen e ankesës.
2. Raporti me rekomandimet përkatëse, nëpërmjet zëvendësit të Avokatit të Popullit i përcillet për miratim Avokatit të Popullit.
3. Në rastet kur shprehen mendime të kundërta mbi çështjen, ndërmjet departamentit përkatës dhe zëvendësit të Avokatit të Popullit, vendimi përfundimtar mbi qëndrimin zyrtar të IAP-së merret nga Avokati i Popullit.

Neni 61

Marrja e vendimit dhe nxjerrja e rekomandimeve

1. Pasi të ketë përfunduar me procedimin e një rasti dhe të jetë konkluduar se ka pasur shkelje apo keqpërdorim të autoritetit, në përputhje me nenin 18 dhe 27 të Ligjit të për

Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit nxjerr vendim në të cilin paraqiten konstatimet dhe rekomandimet e tij për institucionet publike, lidhur me masat e përshtatshme që duhen ndërmarrë.

2. Vendimi i Avokatit të Popullit i dërgohet parashtruesit të ankesës dhe autoriteteve publike përgjegjëse për zbatim brenda një afati të caktuar kohor.
3. Në përputhje me nenin 28 të Ligjit për Avokatin e Popullit, autoritetet të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, përfshirë edhe masat disiplinore, duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor, për veprimet e ndërmarra, lidhur me çështjen në fjalë.
4. Ky afat mund të zgjatet, nëse nga ana e Avokatit të Popullit, parashikohet e nevojshme një gjë të tillë.

Neni 62

Adresimi i çështjes Kuvendit të Kosovës

Nëse pas rekomandimeve të bëra nga Avokati i Popullit, autoritetet administrative apo zyrtarët përkatës nuk ndërmarrin masat e duhura brenda afatit kohor të caktuar ose nuk arsyetojnë mosndërmarrjen e masave të rekomanduara, Avokati i Popullit ia adreson çështjen Kuvendit të Kosovës dhe mund të bëjë deklaratë publike.

Neni 63

Monitorimi i zbatimit të rekomandimeve

1. Departamenti përkatës i hetimeve dhe zëvendësi i Avokatit të Popullit, që është marrë me hetimin e ankesave do të monitorojë marrjen e përgjigjeve nga institucionet publike të cilave u është dërguar rekomandimi për zbatim.
2. Nëse përgjigja nuk vjen brenda 30 ditëve, duhet njoftuar Avokati i Popullit, i cili do të ndjek çështjen tek organi administrativ më i lartë në hierarki.

Neni 64

Konfidencialiteti i çështjeve ndërlidhur me ankesat dhe hetimet

1. Zëvendësit e Avokatit të Popullit, Sekretari i Përgjithshëm, këshilltarët juridikë dhe personeli tjetër nuk shprehin në publik kurrfarë komentesh dhe mendimesh përkitazi me çështjet që kanë të bëjnë me ankesat që i janë parashtruar IAP-së, përveç nëse përcaktohet ndryshe në këtë Rregullore.
2. IAP mban konfidenciale çdo çështje të ndërlidhur me ankesat dhe hetimet përfshirë identitetin e ankuesit dhe regjistrat e IAP-së, me përjashtim të situatave dhe rasteve

kur Avokati i Popullit e konsideron të nevojshme, në përmbushje të përgjegjësive dhe detyrave të përcaktuara me kuadrin ligjor dhe pasqyrimin të tyre në raportet e publikuara, sipas Ligjit për Avokatin e Popullit.

3. Të gjithë zyrtarët e IAP-së që kanë qasje në informata dhe dokumente konfidenciale janë të obliguar që këto informata të mos ia zbulojnë publikut apo autoriteteve dhe se të gjitha dokumentet konfidenciale ruhen në vende të caktuara posaçërisht për këtë qëllim.
4. Avokati i Popullit nuk është i obliguar t'ua tregojë dosjen cilësdo palë.
5. Avokati i Popullit miraton rregulla të posaçme lidhur me çështjen e ruajtjes së shkresave të lëndës dhe të dhënave të tjera konfidenciale të IAP-së që ndërliohen përgjithësisht me procedurën e pranimit dhe hetimit të ankesave dhe administrimit të sistemit të menaxhimit informativ të ankesave.

Neni 65

Përfaqësimi dhe dhënia e këshillave juridike

1. Me qëllim të mbajtjes dhe ruajtjes së pavarësisë dhe paanshmërisë, Avokati i Popullit dhe personeli i IAP-së, në procesin e pranimit dhe hetimit të ankesave:
 - 1.1. nuk duhet të japin këshilla juridike ankuesve;
 - 1.2. nuk përfaqësojnë personat fizikë a juridikë para organeve të administratës publike dhe
 - 1.3. nuk bëjnë interpretimin e ligjeve dhe akteve nënligjore,

Neni 66

Marrja në konsideratë e kompetencave të Avokatit të Popullit

Gjatë punës në një rast të veçantë, zëvendësit e Avokatit të Popullit, drejtorët e departamenteve përkatëse dhe këshilltarët juridikë përgjegjës duhet të marrin parasysh të gjitha kompetencat e Avokatit të Popullit të cilat, përveç nga Ligji për Avokatin e Popullit, dalin edhe nga ligjet e veçanta dhe standardet ndërkombëtare, të adresojnë dhe trajtojnë lëndët në mënyrë efektive, në kohë dhe në interesin më të mirë të ankuesit.

NËNKAPITULLI III

PROCEDURAT E VEÇANTA

Neni 67

Procedura në rastet e përcaktuara në nenin 17 të Ligjit për Avokatin e Popullit, lidhur me parandalim të torturës dhe trajtimeve e ndëshkimeve të tjera mizore, jonjerëzore dhe poshtëruese

1. Në përputhje me nenin 17 të Ligjit për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit vepron si Mekanizëm Kombëtar për Parandalim të Torturës dhe trajtimeve e ndëshkimeve të tjera mizore, jonjerëzore dhe poshtëruese (në tekstin e mëtejshëm: Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës).
2. Në zbatim të këtij mandati ligjor, Avokati i Popullit do të miratojë akt të veçantë nënligjor, përkatësisht procedurë të veçantë të veprimit, me të cilën përcaktohen rregullat, procedura, kriteret e nevojshme dhe hapat që do të ndiqen nga Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës, lidhur me prioritizimin, identifikimin dhe propozimin e veprimeve dhe masave për parandalim të torturës dhe trajtimeve e ndëshkimeve të tjera mizore, jonjerëzore dhe poshtëruese.
3. Pranimi dhe trajtimi i ankesave dhe kërkesave, si dhe vizitat e rregullta dhe pa paralajmërim në të gjitha vendet ku mbahen personat e privuar nga liria, duke përfshirë ndalimin policor, paraburgimin, qëndrimin në institucionet shëndetësore, ndalimin doganor, ndalimin e emigracionit dhe çdo vend tjetër kur dyshohet se ka shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut, do të kryhen nga stafi profesional i Departamentit përkatës për parandalimin e torturës dhe nga ekspertët dhe personat e specializuar të angazhuar nga Avokati i Popullit për nevojat e IAP-së.

Neni 68

Procedura në rastet e përcaktuara në nenin 9 të Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi

1. Në përputhje me ligjin e posaçëm për mbrojtje nga diskriminimi, Avokati i Popullit trajton rastet dhe ankesat që kanë të bëjnë me diskriminimin.
2. Nenet nga Nënkapitulli I dhe Nënkapitulli II, neni 33 e deri te neni 66, të kësaj rregulloreje, përshtatshëmrisht aplikohen edhe për procedurën lidhur me shqyrtimin e ankesave dhe kërkesave për mbrojtje nga diskriminimi.
3. Pranimin, hetimin dhe trajtimin e ankesave dhe kërkesave për mbrojtje nga diskriminimi e bën departamentit përkatës për mbrojtje nga diskriminimi siç përcaktohet me Rregulloren për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës.

Neni 69

Procedura në rastet e përcaktuara në nenin 13 të Ligjit për Barazi Gjinore

1. Në përputhje me Ligjin për Barazi Gjinore, Avokati i Popullit trajton rastet dhe ankesat që kanë të bëjnë me diskriminimin gjinor.
2. Nenet nga Nënkapitulli I dhe Nënkapitulli II, nga neni 33 e deri te neni 66, të kësaj rregulloreje përshtatshëmrisht aplikohen edhe për procedurën lidhur me shqyrtimin e ankesave dhe kërkesave për mbrojtje mbi bazat gjinore.
3. Pranimin, hetimin dhe trajtimin e ankesave dhe kërkesave për mbrojtje nga diskriminimi gjinor, e bën departamentit përkatës për mbrojtje nga diskriminimi, siç përcaktohet me Rregulloren për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës.

Neni 70

Procedura në rastet e përcaktuara në nenin 18, paragrafi 1.3 të Ligjit për Avokatin e Popullit, lidhur me pranimin dhe trajtimin e ankesave të fëmijëve

1. Nenet nga Nënkapitulli I dhe Nënkapitulli II, nga neni 33 e deri te neni 66, të kësaj rregulloreje përshtatshëmrisht aplikohen për procedurën lidhur me pranimin dhe trajtimin e ankesave nga fëmijët, siç është përcaktuar edhe me nenin 18, paragrafi 1.3 të Ligjit për Avokatin e Popullit.
2. Pranimin, hetimin dhe trajtimin e ankesave për të drejtat e fëmijëve e bën ekipi i specializuar për të drejtat e fëmijëve në kuadër të Departamentit përkatës siç përcaktohet me Rregulloren për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës.
3. IAP harton Programin e përhershëm dhe Planin e veprimit lidhur me vetëdijesimin e fëmijëve për të drejtat e tyre dhe rolin e Institucionit të Avokatit të Popullit në mbrojtjen e tyre.

Neni 71

Inicimi i çështjeve në Gjykatën Kushtetuese

1. Në përputhje me nenin 113, paragrafi 2.1, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenin 16, paragrafi 10, të Ligjit për Avokatin e Popullit, si dhe nenin 29 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, Avokati i Popullit mund të iniciojë në Gjykatën Kushtetuese:
 - 1.1. çështjen e përputhshmërisë së ligjeve, të dekreteve të Presidentit e të Kryeministrit dhe të rregulloreve të Qeverisë, me Kushtetutën si dhe
 - 1.2. përputhshmërinë e Statutit të Komunës me Kushtetutën.
2. Me rastin e ngritjes së kërkesës para Gjykatës Kushtetuese kundër aktit të kontestuar, sipas nenit 113, paragrafi 2 të Kushtetutës, duhet specifikuar, *inter alia*, nëse i tërë akti i kontestuar apo pjesë të veçanta të këtij akti konsiderohen të jenë në kundërshtim me Kushtetutën.

3. Kërkesa e parashtruar nga Avokati i Popullit, në veçanti, duhet të specifikojë kundërshtimet e ngritura kundër kushtetutshmërisë së aktit të kontestuar.
4. Departamenti përkatës për çështje juridike i përcaktuar me Rregulloren për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës, përgatit relacionin shpjegues, si dhe raportin me rekomandimin përkatës, lidhur me iniciimin e procedurës kundër aktit të kontestuar sipas nenit 113, paragrafi 2 të Kushtetutës dhe të njëjtin përmes zëvendësit të Avokatit të Popullit, ia përcjell Avokatit të Popullit për aprovim dhe procedim të mëtejshëm.

Neni 72

Pezullimi i vendimeve administrative

1. Sipas nenit 18, paragrafit 5 të Ligjit për Avokatin e Popullit, nëse gjatë hetimeve, Avokati i Popullit konstaton se ekzekutimi i ndonjë vendimi administrativ mund të ketë pasoja të pariparueshme për personin fizik apo juridik, mund të rekomandojë që autoriteti kompetent ta pezullojë ekzekutimin e vendimit në fjalë deri në përfundimin e hetimeve lidhur me këtë çështje nga ana e Avokatit të Popullit.
2. Avokati i Popullit mund të kërkojë nga autoriteti kompetent që ta zbatojnë masën e pezullimit të ekzekutimit të ndonjë vendimi administrativ dhe të caktojnë një afat sipas së cilit pala përgjegjëse mund t'i përgjigjet rekomandimeve të Avokatit të Popullit.
4. Masa e pezullimit të ekzekutimit të vendimit administrativ, e ndërmarre në pajtim me paragrafi 1 dhe 2 të këtij neni, duhet të mbetet në fuqi derisa përfundon hetimi ose deri atëherë kur Avokati i Popullit të propozojë përfundimin e kësaj mase.
5. Avokati i Popullit informon palët apo autoritetet e tjera për rekomandimin e bërë sipas paragrafit 1 dhe 2 të këtij neni, si dhe për përgjigjen e autoritetit të cilit i është adresuar rekomandimi.

Neni 73

Hetimet me vetëiniciativë (*ex officio*)

1. Në përputhje me nenin 16, paragrafët 4, 6 dhe 7 të Ligjit për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit ka kompetencë të zhvillojë hetime me vetëiniciativë, duke u mbështetur në informatat e marra nga çfarëdo burimi apo njohuritë e fituara në mënyrë tjetër, kur ka bazë se nga ana e autoriteteve janë shkelur të drejtat dhe liritë e njeriut të përcaktuara me Kushtetutë, ligje dhe akte të tjera, si dhe me instrumente ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.
2. Kompetencat e Avokatit të Popullit dhe procedurat të cilat ndiqen në rastet e hetimeve me vetëiniciativë janë të njëjta, si në rastet kur zhvillohen hetimet në bazë të ankesës së parashtruar.

Neni 74

Veprimet që ndërmerren si reagim ndaj shkeljeve apo keqpërdorimit të autoritetit

1. Nëse Avokati i Popullit konstaton se një autoritet tjetër, përveç palës përgjegjëse ka kontribuar në shkelje apo keqpërdorim të autoritetit, Avokati i Popullit rekomandon që autoriteti përkatës të ndërmarrë masat e nevojshme.
2. Avokati i Popullit e njofton ankuesin lidhur me rekomandimin e tij për palën përgjegjëse apo autoriteteve tjera të përfshira.
3. Nëse Avokati i Popullit konstaton se nuk ka pasur shkelje apo keqpërdorim të autoritetit, me vendim informon ankuesin për këtë përfundim.

Neni 75

Iniciativat ligjore

1. Në përputhje me nenin 18, paragrafi 1.7, të Ligjit për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit mund të vë në pah nevojën dhe t'i rekomandojë Kuvendit dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës:
 - 1.1. nxjerrjen e ligjeve të reja në Kuvend, ndryshimin e ligjeve që janë në fuqi dhe nxjerrjen apo ndryshimin e akteve nënligjore dhe administrative nga institucionet e Republikës së Kosovës, në mënyrë që të sigurohet pajtueshmëria e sistemit ligjor me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut;
 - 1.2. harmonizimin e legjislacionit me standardet ndërkombëtare për të drejtat dhe liritë e njeriut si dhe zbatimin e tyre efektiv.
2. Departamenti përkatës për çështje juridike i përcaktuar me Rregulloren për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës, pas analizës dhe studimeve të kryera, përgatit relacionin shpjegues si dhe raportin me rekomandimin përkatës për nxjerrjen e ligjeve të reja në Kuvend, ndryshimin e ligjeve që janë në fuqi dhe nxjerrjen apo ndryshimin e akteve nënligjore dhe administrative nga institucionet e Republikës së Kosovës.
3. Avokati i Popullit vendosë në mënyrë të pavarur nëse do të përfshihet në draftimin apo ndryshimin e ligjeve, akteve nënligjore dhe administrative, dhe nëse stafi profesional i tij duhet të merr pjesë në grupet përkatëse të punës.
4. Për të siguruar standardet e mbrojtjes së të drejtave të njeriut, Avokati i Popullit mund të përfshihet në procesin e miratimit apo ndryshimit të ligjeve gjatë dëgjimeve publike ose në procedurat para Kuvendit të Kosovës.

Neni 76

Zvarritja e procedurës gjyqësore

1. Në përputhje me nenin 16, paragrafin 8 të Ligjit për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit mund të jep rekomandime të përgjithshme për funksionimin e sistemit gjyqësor.
2. Avokati i Popullit nuk do të ndërhyjë në rastet dhe në procedura tjera ligjore që janë duke u zhvilluar para gjykatave, përveç rasteve kur konstaton ose vlerëson se mund të ketë pa arsye zvarritje të procedurave gjyqësore.
3. Vënia në pah e zvarritjes së procedurës gjyqësore, përveç nga Avokati i Popullit, në rastet e caktuara parashtrohet edhe nga ana e zëvendësve të Avokatit të Popullit, drejtorëve të departamenteve apo këshilltarët juridikë, varësisht nga objekti i ankesës.

Neni 77

Amicus curiae

Në përputhje me nenin 16, paragrafi 9 të Ligjit për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit, nëse e konsideron të nevojshme për qëllim të mbrojtjes së të drejtave të njeriut, mund të paraqitet në cilësinë e mikut të gjykatës (*amicus curiae*) në proceset gjyqësore që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut, çështjet e barazisë dhe mbrojtjes nga diskriminimi.

Neni 78

Shërbimet e mira, ndërmjetësimi dhe pajtimi

1. Në përputhje me nenin 16, paragrafi 11, në ushtrimin e funksioneve të tij, Avokati i Popullit mund t'u ofrojë shërbime të mira të gjithë banorëve të Republikës së Kosovës si dhe personave të tjerë që ndodhen jashtë territorit të Republikës së Kosovës, ndërkaq bazuar në paragrafin 11, Avokati i Popullit i ushtron kompetencat e veta edhe me anë të ndërmjetësimit dhe pajtimit.
3. Avokati i Popullit mund të fillojë procedurën e ndërmjetësimit në çdo fazë të zhvillimit të procedurës, përkatësisht në momentin kur palët pajtohen dhe arrijnë marrëveshjen për fillimin e procedurës së ndërmjetësimit.
4. Në rastet kur arrihet pajtimi dhe çështja zgjidhet me marrëveshje reciproke dhe vullnetin e plotë të palëve, bëhet pezullimi dhe ndërprerja e hetimeve lidhur me ankesën e parashtruar.
5. Procedura e ndërmjetësimit dhe pajtimit, përveç nga ana e Avokatit të Popullit, në rastet e caktuara zhvillohet edhe nga ana e zëvendësve të Avokatit të Popullit, drejtorëve të departamenteve apo këshilltarëve juridikë, varësisht nga objekti i ankesës.

6. Procedura e ndërmjetësimit është e natyrës konfidenciale dhe se ndërmjetësuesi, palët dhe përfaqësuesit e tyre janë të obliguar që ta ruajnë fshehtësinë e procedurës së ndërmjetësimit, përveç nëse palët pajtohen ndryshe.

KAPITULLI V

BASHKËPUNIMI, RAPORTIMI DHE PROMOVIMI I TË DREJTAVE TË NJERIUT

Neni 79

Promovimi i të drejtave të njeriut

1. Në përputhje me nenin 18, paragrafi 1.4 dhe 1.5 të Ligji për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit, në fushën e promovimit, avancimit dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut:
 - 1.1. bën të njohura të drejtat e njeriut dhe përpjekjet për të luftuar të gjitha format e diskriminimit përmes ngritjes së vetëdijësimit, posaçërisht përmes informimit dhe edukimit edhe me anë të mediave;
 - 1.2. rekomandon Qeverinë, Kuvendin dhe autoritetet e tjera kompetente të Republikës së Kosovës për çështjet që kanë të bëjnë me avancimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, barazisë dhe jo diskriminimit;
 - 1.3. këshillon dhe rekomandon autoritetet e Republikës së Kosovës për programet dhe politikat e tyre për të siguruar mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave dhe lirive të njeriut në Republikën e Kosovës.
2. Departamenti përkatës për çështje të komunikimit, raportimit dhe promovimit të të drejtave të njeriut, i përcaktuar me Rregulloren për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës, kryen hulumtime mbi çështjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, barazisë dhe diskriminimit, përgatitë raporte vjetore, periodike dhe të tjera, mbi bazën e së cilave propozon masat dhe veprimet përkatës edhe inicion, në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse, hartimin e Programit për informimin dhe promovimin e të drejtave të njeriut.
3. Departamenti përkatës përcjell dhe analizon Dokumentet Strategjike të Qeverisë dhe institucioneve tjera, të cilat janë në procedurë hartimi dhe të atyre në zbatim e sipër lidhur me mbrojtjen, mbikëqyrjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut në Republikën e Kosovës dhe varësisht nga gjetjet edhe bën rekomandimet përkatëse në kohë dhe afate optimale.

Neni 80

Monitorimi i gjendjes së të drejtave dhe lirive të njeriut

1. IAP monitoron gjendjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, në bazë të ankesave të pranuar, analizave dhe raporteve të publikuar të organeve shtetërore dhe organizatave të shoqërisë civile; analizave dhe publikimeve të organizatave ndërkombëtare si dhe në bazë të informacioneve të publikuar në media.
2. Në bazë të të dhënave të grumbulluara, IAP vë në dukje nevojën për ndërmarrjen e masave dhe kryerjen e aktiviteteve promovuese që synojnë mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut dhe luftën kundër diskriminimit, që është në përgjegjësinë e Avokatit të Popullit.

Neni 81

Hulumtime dhe analiza

1. Në kuadër të përgjegjësisë që ka në mbrojtjen, mbikëqyrjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut, Avokati i Popullit kryen dhe publikon hulumtime dhe analiza lidhur me mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut.
2. Kryerja e hulumtimeve dhe analizave bëhet duke përdorur metoda të ndryshme të hulumtimit, në bazë të ankesave të qytetarëve në shqyrtim e sipër, informacioneve dhe burimeve të tjera në dispozicion.
3. Në bazë të të dhënave të mbledhura nga analizat dhe hulumtimet, Avokati i Popullit vendos për ndërmarrjen e masave të tjera brenda kompetencave dhe përgjegjësisë të tij.

Neni 82

Bashkëpunimi me organizatat e shoqërisë civile

1. Përgjatë punës së tij, Avokati i Popullit në pajtim me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi, bashkëpunon me të gjitha organizatat dhe institucionet vendore dhe ndërkombëtare që merren me mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut.
2. Bashkëpunimi me organizatat e shoqërisë civile bëhet përmes organizimit të përbashkët të dëgjimeve publike, organizimit të aktiviteteve të përbashkëta për ngritjen e vetëdijesimit dhe ndërgjegjësimin e opinionit publik për rëndësinë e të drejtave të njeriut, pjesëmarrjes dhe bashkëpunimit në projekte të veçanta që ndërlidhen me rastet e veçanta të shkeljeve të të drejtave të njeriut dhe lirisë nga fushëveprimi i IAP-së.

Neni 83

Bashkëpunimi ndërkombëtar dhe i brendshëm

1. IAP-i vendos dhe zhvillon bashkëpunim me institucionet vendore dhe organizatat ndërkombëtare të cilat janë aktive në lëmin e mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave të njeriut.
2. Çfarëdo bashkëpunimi i referuar në paragrafin (1) të këtij neni duhet të zbatohet në atë mënyrë që ruan pavarësinë e IAP-së siç është përcaktuar në Kushtetutë dhe Ligjin për Avokatin e Popullit.
3. Departamenti përkatës i IAP-së do të zhvilloi një bazë të dhënash të projekteve të mëparshme dhe atyre në vijim e sipër, lidhur me asistencën e ofruar teknike.
4. Baza e të dhënave të projekteve duhet të përfshijë të dhëna për caqet dhe aktivitetet e zhvilluara, donatorët, njësit zbatuese dhe partnerët, ekspertët e përfshirë, buxhetet, rezultatet e arritura, periudhat e zbatimit, në bashkëpunim me të gjitha palët e interesuara dhe të shkëmbimit të përvojave me qëllime të koordinimit të projekteve të reja me aktivitetet e mëparshme, për të shmangur dyfishimin e përpjekjeve dhe për të përshtatur ato me rezultatet dhe mësimet e nxjerra nga përvojat e kaluara si dhe të krijojë një platformë bashkëpunimi në nivel lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare, nëpërmes të menaxhimit dhe përditësimit të bazës së të dhënave për projekte.

Neni 84

Plani i punës

1. Aktivitetet e IAP-së përcaktohen me Planin Vjetor të punës, të miratuar nga Avokati i Popullit
2. Plani vjetor i punës përmban:
 - 2.1. një pasqyrë të përgjithshme të detyrave dhe aktiviteteve;
 - 2.2. informacion mbi objektivat të cilat planifikohen për të arritur, të cilat janë të ndërlidhura me objektivat e përgjithshme dhe specifike që dalin nga të Plani (Programi) strategjike për periudhën tre-vjeçare;
 - 2.3. koston buxhetore të aktiviteteve të planifikuara, si dhe
 - 2.4. të dhënat mbi rreziqet më të rëndësishme që mund të ndikojë në arritjen e qëllimeve të caktuara .
3. Të gjitha departamentet, zyrat dhe njësitë e IAP-së miratojnë planet e punës, të bazuara në planin e përgjithshëm të punës së IAP-së dhe objektivat strategjike të punës, sipas Programit strategjik të zhvillimit të IAP-së.

Neni 85

Raportet vjetore të Avokatit të Popullit

1. Në përputhje me obligimet që dalin nga neni 29 i Ligjit për Avokatin e Popullit dhe ligjet e veçanta, Avokati i Popullit i paraqet Kuvendit të Republikës së Kosovës. Raportin e rregullt vjetor për vitin paraprak deri më 31 mars të vitit vijues.
2. Përpilimi i Raportit vjetor, bëhet mbi bazën e raporteve vjetore të punës së departamenteve dhe njësive përbërëse të IAP-së.
3. Raporti vjetor i punës i përmbledhur nga Departamenti përkatës, fillimisht shqyrtohet nga Kolegjiumi i IAP-së dhe i përcillet Avokatit të Popullit për miratim jo më vonë se data 15 dhjetor për çdo vit kalendarik.
4. Raporti vjetor i Avokatit të Popullit duhet të përmbaj konstatime për nivelin e respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe mbrojtjen ligjore të qytetarëve të Republikës së Kosovës; informacion mbi punën e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e torturës, mbrojtjen nga diskriminimi dhe barazinë gjinore, paraqitjen statistikore të ankesave të pranuar dhe të proceduara, përkrahimin e rasteve tipike të shkeljeve apo keqadministrimit si dhe një pasqyrë të aktiviteteve të tjera me interes për mbrojtjen, mbikëqyrjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut.

Neni 86

Raportet e veçanta të Avokatit të Popullit

1. Në përputhje me nenin 30 të Ligjit për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit paraqet edhe raporte të veçanta për fusha të caktuara të të drejtave të njeriut.
2. Raportet e veçanta Avokati i Popullit i paraqet kur konstaton se ka ndodhur diskriminimi dhe se ka ardhur deri te kërcënimi i të drejtave kushtetuese dhe ligjore të qytetarëve të Kosovës për shkak të veprimeve apo mosveprimeve që paraqesin keqpërdorim të autoritetit.
3. Në përgatitjet dhe hartimin e raporteve të veçanta marrin pjesë zëvendës Avokatët e Popullit dhe udhëheqësit e departamenteve përkatëse nga fusha e shërbimeve profesionale.
4. Mënyra e hartimit dhe përmbajtja e çdo raporti të posaçëm propozohet nga Kolegjiumi i IAP-së, ndërsa vendoset nga Avokati i Popullit.

KAPITULLI VI

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 87

Dispozitat kalimtare

1. Me kusht që të mos jenë në kundërshtim me këtë Rregullore Pune, hetimi i ankesave dhe trajtimi i kërkesave të parashtruara, para se të hyjë në fuqi kjo rregullore, do të vazhdojnë së proceduari në përputhje me kuadrin ligjor dhe procedurën e parashikuar sipas Rregullores së mëhershme së punës.
2. Rastet e parandalimit të torturës, me kusht që të mos jenë në kundërshtim me ligjin në fuqi për Avokatin e Popullit dhe këtë rregullore, deri në funksionalizimin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalim të torturës dhe trajtimeve e ndëshkimeve të tjera mizore, jonjerëzore dhe poshtëruese, sipas nenit 17 dhe 38.3, të Ligjit për Avokatin e Popullit vazhdojnë së proceduari në përputhje me procedurën e parashikuar, sipas rregullores së mëhershme të punës së IAP-së dhe Marrëveshjes së Bashkëpunimit në mes të Institucionit të Avokatit të Popullit të Kosovës, Qendrës Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës dhe Këshillit për Mbrojtjen e të Drejtave e të Lirive të Njeriut.

Neni 88

Ndryshimet e rregullores

Kjo Rregullore e punës dhe procedurat e brendshme mund të ndryshohen në çdo kohë në procedurë të njëjtë nga Avokati i Popullit.

Neni 89

Përgjegjësia dhe kontrollimi i zbatimit të Rregullores

Përgjegjës për zbatimin e kësaj rregulloreje janë zëvendësit e Avokatit të Popullit dhe të gjitha njësitë organizative të IAP-së, ndërsa kontrollimi i zbatimit të saj dhe akteve të tjera nënligjore të nxjerra në zbatim të kësaj rregulloreje, ushtrohet nga Avokati i Popullit dhe Sekretari i Përgjithshëm i IAP-së.

Neni 90

Shfuqizimi

Pas hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, shfuqizohet Rregullorja e Punës, e miratuar me vendimin e Avokatit të Popullit, nr. 01/2011, të datës 21 mars 2011 dhe e publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, më 31 mars 2011.

Neni 91

Aktet nënligjore

Vendimet dhe aktet e tjera nënligjore përkatëse të parapara me këtë rregullore duhet të miratohen brenda dymbëdhjetë (12) muajve, pas hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje.

Neni 92

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Prishtinë, 26 maj 2016

Hilmi Jashari

Avokat i Popullit